



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 947/ 11 prot.

Datë 09/06/2026

V E N D I M

Nr. 773/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/06/2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe të paraqitura nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “ZENIT&CO” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe

ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “ARENA MK” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “NET-GROUP” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “CIVIL CONS” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “ERALD-G” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: *Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, me NIPT K72113010E, me adresë: Rruga “Mujo Ulqinaku”, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: *Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA)
Adresa: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9.*

Subjekt i interesuar: *Operatori ekonomik “ZENIT&CO” SHPK me NIPT K61731002D dhe me adresë: Tiranë, Rruga “Myrteza Topi”, Nd.18, Ap.38.*

Operatori ekonomik “ARENA MK” SHPK me NIPT L67619801Q dhe me adresë: Ballsh Fier Ballsh, Fshati Ninësh Rruga Dames - Ninesh; Ndërtesa 4; Lagja “Memaj” Nj.Adm.Fratar, Bashkia Mallakastër.

Operatori ekonomik “NET-GROUP” SHPK me NIPT L72023002P dhe me adresë: Tiranë Rruga “Vorpset”, pas restorant “Piazza”, ZK 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2.

Operatori ekonomik “CIVIL CONS” SHPK me NIPT L81315015O dhe me adresë: Gjirokastër, Lagjia “18 Shtatori” Rruga “18 Shtatori”, Godinë 9 katëshe, kati 1-rë, objekti 15/5.

Operatori ekonomik “ERALD-G” SHPK me NIPT K36306784K dhe me adresë: Dibër Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.12.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike –

Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

II.2. Në datë 30.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 18.03.2026 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"NET-GROUP " SHPK	me ofertë	26.465.686,52	leke	94.20	pikë	kualifikuar
2	"ERALD-G" SHPK	me ofertë	26.770.000,00	leke	92.70	pikë	kualifikuar
3	"ARENA MK" SHPK	me ofertë	29.083.172,00	leke	90.30	pikë	kualifikuar
4	"CIVIL CONS" SHPK	me ofertë	25.302.359,00	leke	89.40	pikë	kualifikuar
5	"ZENIT&CO" SHPK	me ofertë	27.629.013,40	leke	88.20	pikë	kualifikuar
6	"A & E ENGINEERING" SHPK	me ofertë	25.593.191,40	leke	87.60	pikë	kualifikuar
7	"ATELIER 4" SHPK	me ofertë	27.595.000,00	leke	87.00	pikë	kualifikuar
8	"SRP ALBANIAN ENGINEERING" SHPK	me ofertë	26.975.500,00	leke	86.10	pikë	kualifikuar
9	"HYDRO-ENG CONSULTING " SHPK	me ofertë	26.174.855,00	leke	84.60	pikë	kualifikuar
10	"InfraKonsult" SHPK	me ofertë	26.155.400,00	leke	84.60	pikë	kualifikuar
11	"Engineering Consulting Group " SHPK	me ofertë	27.629.013,00	leke	83.70	pikë	kualifikuar
12	"Noor Engineering" SHPK	me ofertë	27.485.000,00	leke	83.40	pikë	kualifikuar
13	"TOËER" SHPK	me ofertë	27.629.020,00	leke	82.50	pikë	kualifikuar
14	"GJEOKONSULT & CO" SHPK	me ofertë	27.629.013,00	leke	81.90	pikë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 24.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik "NET-GROUP" SHPK, operatorin ekonomik "ERALD-G" SHPK dhe bashkimin e operatorëve ekonomikë "ARENA MK SHPK & HTS COMPANY SHPK", duke publikuar vlerësimin e ofertave të paraqitura, si më poshtë vijon:

1	"NET-GROUP " SHPK	me ofertë	26.465.686,52	leke	94.20	pikë	kualifikuar
2	"ERALD-G" SHPK	me ofertë	26.770.000,00	leke	92.70	pikë	kualifikuar
3	"ARENA MK" SHPK	me ofertë	29.083.172,00	leke	90.30	pikë	kualifikuar

4	"CIVIL CONS" SHPK	me ofertë	25.302.359,00	leke	89.40	pikë	kualifikuar
5	"ZENIT&CO" SHPK	me ofertë	27.629.013,40	leke	88.20	pikë	kualifikuar
6	"A & E ENGINEERING" SHPK	me ofertë	25.593.191,40	leke	87.60	pikë	kualifikuar
7	"ATELIER 4" SHPK	me ofertë	27.595.000,00	leke	87.00	pikë	kualifikuar
8	"SRP ALBANIAN ENGINEERING" SHPK	me ofertë	26.975.500,00	leke	86.10	pikë	kualifikuar
9	"HYDRO-ENG CONSULTING " SHPK	me ofertë	26.174.855,00	leke	84.60	pikë	kualifikuar
10	"InfraKonsult" SHPK	me ofertë	26.155.400,00	leke	84.60	pikë	kualifikuar
11	"Engineering Consulting Group " SHPK	me ofertë	27.629.013,00	leke	83.70	pikë	kualifikuar
12	"Noor Engineering" SHPK	me ofertë	27.485.000,00	leke	83.40	pikë	kualifikuar
13	"TOËER" SHPK	me ofertë	27.629.020,00	leke	82.50	pikë	kualifikuar
14	"GJEOKONSULT & CO" SHPK	me ofertë	27.629.013,00	leke	81.90	pikë	kualifikuar

II.5. Në datën 27.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6458 datë 27.03.2026, dhe me numër protokoll nr. 947/2026 prot, datë 30.03.2026 e operatorit ekonomik "A & E ENGINEERING" SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues "A & E ENGINEERING" SHPK, si dhe mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar dhe konkretisht të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "ZENIT&CO" SHPK, të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "ARENA MK" SHPK, të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "NET-GROUP" SHPK, të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "CIVIL CONS" SHPK dhe të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "ERALD-G" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 947/1, datë 30.03.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "A & E ENGINEERING" SHPK, mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues "A & E ENGINEERING" SHPK, si dhe mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar dhe konkretisht të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "ZENIT&CO" SHPK, të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "ARENA MK" SHPK, të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "NET-GROUP" SHPK, të propozimeve teknike të operatorit ekonomik "CIVIL CONS" SHPK dhe të propozimeve

teknike të operatorit ekonomik “ERALD-G” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 947/2 prot., datë 08.04.2026 me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që të dërgojë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e procedurës së prokurimit ku të përfshihet procesverbali vlerësimit në lidhje me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit me pikë të ofertave të secilit operator ekonomik pjesëmarrës së bashku me argumentimet përkatëse për secilin komponentë si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “A & E Engineering” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 2327/3 prot, datë 07.04.2026 “*Dërgohet vendimi i arsyetuar*” protokolluar me tonën me nr. 947/3 prot, datë 10.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, shkresa nr. 3237/2 prot, datë 07.04.2026 “*Vendim*”, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*A & E Engineering*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Me shkresën nr. 2546/1 prot, datë 16.04.2026 “*Kthim përgjigje shkresës Nr. 947/2 prot, datë 08.04.2026*” protokolluar me tonën me nr. 947/4 prot, datë 20.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, shkresa nr. 3237/2 prot, datë 07.04.2026 “*Vendim*”, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*A & E Engineering*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.10. Me shkresën nr. 947/5 prot., datë 23.04.2026 me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda dy ditësh nga marrja e kësaj shkrese, procesverbalin e vlerësimit në lidhje me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit me pikë të ofertave të secilit operator ekonomik pjesëmarrës, së bashku me argumentimet përkatëse për secilin komponentë, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.11. Me shkresën nr. 2837/1 prot, datë 28.04.2026 me objekt “*Kthim përgjigje shkresës Nr. 947/5 prot, datë 23.04.2026*” protokolluar me tonën me nr. 947/6 prot, datë 30.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, procesverbalin e vlerësimit të ofertave të paraqitura i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” SHPK, si në vijim: “... Në lidhje me rezultatin e vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a, për vitin 2025”, shprehim rezervat tona lidhur me pikëzimin e bërë ndaj ofertës së shoqërisë sonë.

...

Sipas kërkesave të DST-së nga autoriteti kontraktor, ne si operator pjesëmarrës kemi paraqitur të gjitha dokumentat e kërkuara për vlerësimin e kësaj procedure.

- Përvoja për Punë të Ngjashme.

Shoqëria jonë ka paraqitur eksperiencë të konsiderueshme në realizimin e punimeve civile dhe elektrike, të cilat janë të ngjashme me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në mënyrë të veçantë, janë paraqitur kontrata që përfshijnë mbikëqyrjen e punimeve elektrike në objekte të ndryshme.

Megjithatë, autoriteti kontraktor nuk i ka marrë në konsideratë këto punime me arsyetimin se vlera e punimeve elektrike të paraqitura nuk arrin pragun prej 10,000,000 lekë.

Vlerësojmë se ky interpretim është i ngushtë dhe jo në përputhje me qëllimin e kriterit, pasi:

- Punimet e paraqitura janë të ngjashme në natyrë dhe kompleksitet me objektin e prokurimit;

- Eksperienca duhet të vlerësohet në tërësi (punime civile dhe elektrike të integruara), dhe jo në mënyrë të fragmentarizuar vetëm mbi bazën e një komponenti të veçantë;

- Kriteri i vendosur cënon parimin e proporcionalitetit dhe kufizon konkurrencën, duke përjashtuar operatorë me eksperiencë reale dhe të provuar.

Theksojmë se përvoja në punë të ngjashme e tre viteve të fundit nuk pasqyron realisht të gjithë përvojën e kompanisë. A& E Engineering shpk është themeluar në vitin 2007 dhe që prej 19 vitesh ka përmbushur me sukses shumë kontrata supervizioni të objekteve të kategorive tëndryshme, si nëvlerë dhe në natyrë punimesh.

- Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Shoqëria jonë ka paraqitur një staf teknik të kualifikuar e me eksperiencë të konsiderueshme në mbikëqyrjen e punimeve dhe realizimin e projekteve të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi.

Dokumentacioni i dorëzuar përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe demonstroi qartë kapacitetin profesional për realizimin e këtij shërbimi.

Gjithashtu, konstatojmë se nuk kemi marrë asnjë vlerësim apo koment nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me stafin e propozuar për këtë procedurë, çka bie ndesh me parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

- Metodologjia e Propozuar & Grafiku i punimeve

Në metodologjinë e Propozuar ne kemi analizuar dhe sqaruar qëllimin tonë si mbikëqyrës në zbatimin e kësaj kontrate. Kemi analizuar objektivat kryesorë, detyrat si dhe përgjegjësitë tona për realizimin me sukses të mbikëqyrjes së kontratës. Është përcaktuar plani i punës që do duhet të përmbahet secili inxhinier, detyrat dhe përgjegjësitë dhe alternimi i tyre. Është

përcaktuar Grafiku i punimeve për kohëzgjatjen 24 (njetet e katër) muaj të kontratës dhe është pasqyruar ndarja dhe kohëzgjatja e secilës prej proceseve të punës.

Autoriteti kontraktor ka penalizuar ofertën tonë me arsyetimin se metodologjia e paraqitur është “e përgjithshme” dhe nuk përfshin detaje të thelluara mbi proceset teknike të realizimit të punimeve (si energjizimi i linjave dhe nënstacioneve, testimet, etj.).

Ky vlerësim është i pabazuar dhe në kundërshtim me natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Operatori ynë ekonomik merr pjesë në këtë procedurë në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, dhe jo si zbatues i tyre.

...

Krahasuar me Operatorët e renditur me më shumë pikë se ne, AK për vlerësimin e tyre përshkruan me terma të përgjithshme dhe pa u analizuar konkretisht tek metodologjia e tyre dhe duke përdorur terma subjektivë. (p.sh është shpjeguar qartë mënyra e ndjekjes së kontratës; “metodologjia duket e plotë”)

Për më tepër, përdorimi i të njëjtave formulime standarde dhe përgjithësuese për disa operatorë ekonomikë tregon mungesë të një vlerësimi individual dhe objektiv të ofertave.

Për sa më sipër, ne si operator ekonomik pjesëmarrës nuk jemi informuar apo vënë në dijeni deri më sot, mbi ofertat ekonomike të paraqitura nga të gjithë operatorët pjesëmarrës, si dhe nuk na është vënë në dispozicion ndonjë formular vlerësimi për pikëzimin e dhënë nga secili anëtar i KVO-së.

Në lidhje me këtë procedurë, ne si operator pjesëmarrës, kërkojmë që KPP të shqyrtojë vlerësimet e KVO-së dhe të kryhet rivlerësimi i ofertave në mënyrë objektive dhe transparente.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Seksionin 2 “Objekti i Kontratës”, pika 2.7 “Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e marrëveshjes kuadër, duke përcaktuar numrin maksimal të operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet marrëveshja kuadër, si më poshtë:

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 3(tre) (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

III.1.2. Në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së fituesit, si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

➤ **Çmimi [0 - 50] pikë**

➤ **Metodologjia e propozuar** (Përqsja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative) **[0 -30] pikë**

- **Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar [0 -10]**
- **Përvoja per punë të ngjashme (vlera ose natyra e kontratave te realizuara) [0 -10]**

III.1.3. Në Shtojcën 7 “FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojet dhe afatin e kryerjes së shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

“Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” sipas Termave të References.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates.

1	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Ndërtimi i Nënstacionit të ri 220/110 kV Traktora (ngjitur me nënstacionin ekzistues Traktora 110/20 kV), me një autotransformator 1x150 MVA”	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates
2	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Linja Tirana 1 - Traktora”	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates
3	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Fuqizim i linjës 110 kV Kafaraj - Vlora 1 - Babicë dopio qark dhe shtrirje përcjellësi në një qark”	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates
4	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Linja e re dopjo qark Sharrë-Selitë dhe traktet përkatëse”	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates
5	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Ndërtimi i linjës së re Çorovodë - Këlcyrë tek qark si dhe traktet përkatëse”	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates
6	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Rikonstruksion i linjës Fier-Kafaraj dopio qark dhe trakt i ri linje 110 kV në N/St. Fier”	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates
7	Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Ndërtimi i linjës 110 kV Zogu i Zi – Tirana Qendër dhe punime në N/Stacionin	Komplet	1	24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e mini-kontrates

	<i>Tirana Qendër</i>			
8	<i>Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Mbrojtja e bazamenteve të shtyllës Nr. 93 të linjës 110 kV Ulëz-Kurbnesh”</i>	<i>Komplet</i>	<i>1</i>	<i>24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja ne fuqi e mini-kontrates</i>
9	<i>Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”</i>	<i>Komplet</i>	<i>1</i>	<i>24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja ne fuqi e mini-kontrates</i>
10	<i>Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Kalimi në kabllor i segmentit të linjës 110 kV Traktora – Farkë në hyrje të N/St. Farkë”</i>	<i>Komplet</i>	<i>1</i>	<i>24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja ne fuqi e mini-kontrates</i>
11	<i>Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Punime primare, furnizim dhe vendosje e një autotransformatori të ri trefazor 220/110 kV, 150 MVA, punime sekondare për përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese në nënstacionin Hoxhare”</i>	<i>Komplet</i>	<i>1</i>	<i>24 (njetzet e kater) muaj nga hyrja ne fuqi e mini-kontrates</i>

Shenim: Afati i zbatimit të mini-kontrates së mbikëqyrjes mund të zgjatet edhe me shumë se 24 (njetzet e kater) muaj, në varësi të ecurisë së kontrates së punimeve objekt mbikëqyrjeje.

III.1.4. Në Shtojcën 8 “**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar termat e referencës së shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objektivi kryesor i punës:

Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për çdo objekt që realizohet me investimet e parashikuara nga OST sh.a. për vitin 2025. Mbikëqyrja e punimeve ka për qëllim dhe përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, rregullat dhe standartet teknike të projektimit, të zbatimit, kushteve të kontratës si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij.

Mbikëqyrja e punimeve për objektet në fjalë kryhet vetëm nga persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, të licencuar për ushtrimin e mbikëqyrjes së punimeve, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të pajisur me NIPT.

- A. Baza ligjore,** kryesisht ku mbikëqyrësi i punimeve i objekteve që realizohen me investimet e parashikuara nga OST sh.a., mbështetet për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij, janë:

- Ligjit Nr.8402, dt. 10.09.1998 **“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”** (me udhëzimet përkatëse të përfshira)
- VKM nr. 610 datë 22.09.2022 **“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”**

Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e mbikëqyrësit

Para fillimit të zbatimit të punimeve

OST sh.a caktimin e mbikëqyrësit, e kryen duke pasur parasysh llojin e punimeve që do të mbikëqyrjen në zbatimin e veprës. Mbikëqyrësi përcaktohet në bazë të licencës profesionale të mbikëqyrjes që disponon dhe pikëve të kualifikimit, të cilat përkojnë me zërat e punimeve që do të kryhen në objekt.

Mbikëqyrësi i punimeve si person fizik apo juridik, i licencuar, është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mbulon çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij gjatë procesit të ndërtimit të objektit.

OST sh.a., si Autoritet kontraktor lidh kontratë me mbikëqyrësin e punimeve, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella, kushtet e punës, tarifen etj. (VKM nr. 610, dt.22.09.2022)

Mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga autoriteti kontraktor për kontratën e lidhur me zbatuesin e punimeve dhe të nënkontraktorëve të mundshëm që zgjedh zbatuesi i punimeve, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

Mbikëqyrësi në fillim të punimeve për secilin nga objektet e parashikuara për vitin 2025 merr kontakt me organet qeverisjes vendore në juridiksionin e të cilit ndodhet objekti ose on-line (e-leje), ku kryhen punimet e këtij objekti dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti,

Mbikëqyrësi i punimeve para fillimit të punimeve bën verifikimin paraprak, që konsiston në:

- a.verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
 - b. verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet;
 - c. verifikimin e mangësive të projektit të zbatimit
 - d. njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe të të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate;
 - e) marrjen në dorëzim të punës, njohjen me stafin drejtues të kontraktorit si dhe makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit sipas kushteve të kontratës.
- Njohjen dhe marrjen në dorëzim të furnizimeve të materialeve nga zbatuesi i punimeve, duke mbajtur një procesverbal për rezultatin e marrjes në dorëzim;
- f. Laboratorin e akredituar që do të kryhej testet e materialeve.
 - g. Verifikon vendosjen e tabelës së identifikimit në kantier me të dhënat e mëposhtme:

Emërtimi i objektit:

Autoriteti kontraktor: **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” Sh.a.**

Projektuesi i objektit:

Kontraktori I punimeveve:

Drejtuesi teknik I kontraktorit.....

Mbikëqyrësi i punimeve:sh.p.k.

Afati i ndërtimit të objektit: muaj

Vlera e objektit sipas formularit të ofertes fituese: me TVSH lek

Mbikëqyrësi duhet të këmbëngulë tek masat e marra nga ana e sipërmarrësit për sigurinë e objektit në kantier duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese dhe treguese të sigurisë, shiritave, etj, sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut, Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 312, dt 05.05.2010 **“Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK).**

Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë OST-së të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:

- Staf i Sipërmarrësit
- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit, shtrimin e linjave, hapjen e rrugëve kapacitetet teknike të makinerive sipas kushteve të vecanta të kualifikimit, etj.
- Laboratorin e akredituar që do të kryhej testet e materialeve.

• **Zbatimi i punimeve**

Në momentin e fillimit të zbatimit, mbikëqyrësi paraqet pranë Autoritetit kontraktor OST-së **stafin e tij mbikëqyrës që do të monitorojë sistematikisht punimet në përbërje të së cilit duhet të ketë:**

a. Mbikëqyrësi i punimeve (për kontratat me punime kryesisht ndertimore) që duhet të jetë inxhinier ndërtimi, person fizik apo juridik me licensën profesionale përkatëse për keto lloj punimesh, me eksperiencë pune në mbikëqyrje dhe keto lloj punimesh. Kryen të gjitha detyrat e pecaktuara në:

- Ligjin Nr.8402, dt. 10.09.1998 **“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”** (me udhëzimet përkatëse të përfshira) që nuk përfshihen në detyrat e mbikëqyrësve që vijnë më poshtë.

b. Mbikëqyrësin për punimet topografike duhet të jetë inxhinier topograf me licensën profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit. Mbikëqyrësi për punimet topografike për, kryesisht për kontratat e ndërtimit të linjave TL duhet të jetë i pranishëm me kohë të plotë në fazat e piketimit të bazamenteve të shtyllave, gjatë gërmimit, nivelimit të shtresave paraprake, montimi i stabeve me shabllon dhe betonimi i kollonave (tytave). Para shtrirjes së përcjellësve në linja kontrollon vertikalisht shtyllat të montuara dhe gjatë shtrirjes së përcjellësve dhe troseve mbikëqyr tërheqjen e përcjellësve për varjen e tyre sipas projektit (shigjeta “f”) dhe tolerancave të parashikuara në KTZ për LTL dhe largësitë e distancave elektrike të përcjellësve dhe trosit nga trupi i shtyllës dhe toka si dhe objektet në afërsi të linjës.

Për punimet në nënstacione, do të mbikëqyrë të gjitha punimet e piketimit të bazamenteve të portaleve, piketimin e shablloneve të montimit të bulonave të ankerimit të konstruksioneve të çelikut të pajisjeve primare, konstruksionet e çelikut.

Mbikëqyr të gjitha punimet e piketimit të trasesë së rrugëve të përkohëshme dhe të përhershme në linja, si dhe piketimin e shesheve dhe kuotave të mbushjeve me shtresa

brenda nënstacioneve (sheshet e trakteve). Nënshkruan në të gjitha proces verbalet tip të piketimit (shih shtojcat)

- c. Mbikëqyrës për punimet elektrike duhet të jetë inxhinier elektrik me licence profesionale perkatese, me eksperience pune në shtrimin e linjave, trosit OPGË, TLC-ve, RTU-ve, si dhe pajisjeve primare/sekondare, komadimit, matjes dhe të mbrojtjes SCADA te nenstacioneve. Ky i fundit kontrollon dhe miraton të gjitha materialet, pajisjet dhe punimet elektrike të objektit (montimin e pajisjeve, tokezimin e bazamenteve për kapjen e rezistencës ohmike sipas projektit, izolacionit sipas projektit, testet etj.) si dhe plotesimin e shtyllave me tabelat treguese të linjes dhe shtylles dhe të rrezikut nga tensioni i larte.
- d. Mbikëqyrësi për punimet gjeologjike, verifikon gjendjen e tabanit dhe konfirmon gjendjen e tij së bashku me gjeoteknikun e zbatimit, duke marrë pjesë në process-verbalin të konformitetit gjeoteknik për çdo taban bazamenti dhe jep rekomandimet e tij për mbrojtjen e bazamenteve të shtyllave nga fenomenet negative të rrëshqitjes sipërfaqësore dhe ujrave të shiut dhe nëntokësore sipas gjendjes faktike në objekt.
- e. Mbikëqyrësi për punimet mekanike, kontrollon dimensionet, cilësitë fiziko – mekanike, kontrollon me përgjegjësi galvanizimin me zink të shtyllave metalike të LTL (cilësia dhe trashësia e veshjes së zinkimit) dhe të konstruksioneve mbi bazamentet e portaleve, suporteve të pajisjeve, cilesine e saldimeve, lidhjet dhe shtrengimin me bulona të profileve, etj, konform standarteve të parashikuara në specifikimet teknike të projektit të miratuar dhe rregullave dhe standarteve teknike të projektimit dhe zbatimit në fuqi për keto lloj punimesh.
Duhet të ketë eksperiencë edhe për sistemet e kondicionimit dhe ajrimit të godinave.
- f. Inxhinier mjedisi, mbikëqyr të gjitha problemet mjedisore gjatë zbatimit të punimeve që efekti negativ në mjedis nga punimet që do kryhen dhe pajisjet që do të montohet, të jete sa më i vogël në fazën e ndërtimit dhe të zhfrytezimit normal të objektit.

- **Mbikëqyrësi ka përgjegjësi:**

Duke qenë një nga përgjegjësit kryesor për ndërtimin e objektit Mbikëqyrësi i punimeve, ai ka për detyrë të respektojë rigorozisht kushtet e kontratës së nënshkruar midis kontraktorit të punimeve dhe OST-së, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit, si dhe të kostos së realizimit të objektit.

1. Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, standartet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruar nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit.
2. Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë deri në zëvendësimin me materiale të tjera të cilësisë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara, me shpenzimet e sipërmarrësit.
3. Të kërkojë certifikatat e cilësisë dhe konformitetit të pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.

4. Të kërkojë dhe të marrë pjesë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
5. Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt.
6. Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.
7. Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me proçes-verbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt- zbatimit.
8. Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në raport të drejtë me vëllimet e realizuara. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
9. Kur mbikëqyrësi i punimeve gjykon se ka dëmtime të rënda të strukturave , pezullon punimet dhe kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
10. Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt-zbatimin ose në Specifikimet Teknike.
11. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, kur punimet kryhen në kushte moti të papërshtatshme, në çdo rast me miratimin e Autoritetit Kontraktor OST sh.a., për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Mbikëqyrësi së bashku me Autoritetin kontraktor OSTsh.a. dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit të punimeve, duke marrë parasysh të gjithë faktorët objektivë që kanë penguar ecurinë e punimeve, sipas grafikut të miratuar
12. Gjatë zbatimit të projektit, mbikëqyrësi i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme, dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë nga mbikëqyrësi i punimeve. Për çdo punim të dukshëm ose të padukshëm, në të gjitha fazat e ndërtimit, të bëjë fotografimin/regjistrimin dhe matjet e tij dhe të mbaj proces - verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
13. Në fund të çdo ditë pune, verifikon ditarin e punimeve dhe e firmos atë.
14. Kontrollon në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit, kuotat e thellësisë së bazamenteve, kuotat e vendosjes së shtyllave, shtrirje tërheqje përcjellësi/trosi
15. Ndjek në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proçeset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
16. Kërkon në mënyrë korrekte zbatimin e plan – organizimit të punimeve të objektit.
17. Kontrollon bazamentin e objektit të përfunduar dhe jep miratimin e tij për vazhdim të punimeve.

18. Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekt-Preventivin e parashikuar ose rishikimin e projektit, Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar në rastin e kontratave me “punime në matje” dhe gjithmone me miratimin e Autoritetit Kontraktor OST sh.a. dhe i raporton periodikisht, çdo muaj, këtij autoriteti për gjendjen e tij. Nëse ka vërejtje në përdorimin e fondit rezervë, njofton zbatuesin e punimeve dhe merr masat e nevojshme për përdorimin e këtij fondi, për të cilin duhet të dakordësohen të dyja palët. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga autoriteti kontraktor për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve të dakordësuara.
19. Mbikëqyrësi duhet të firmosë gjithë dokumentacionin që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin për dokumentacionin teknik. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikëqyrësi i dorëzohet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit të objektit.
20. Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paafësi ose pakujdesi të rëndë në punë.
21. Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
22. Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për sigurimin teknik në kantier.

• **Përgjegjësia profesionale e mbikëqyrësit dhe penalitetet për moszbatim të detyrimeve kontraktuale**

Kompania OST sh.a., ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit, kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, lejim të përdorimit të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike, moskryerje të testeve, etj.

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, kompania OST-Sha, ka të drejtë të urdhërojë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të neneve, 15 dhe 16, të kreut III, të ligjit Nr 8402, dt 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të përditësuar.

Mbikëqyrësi i punimeve si person fizik apo juridik, i licencuar, është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mbulon çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij gjatë procesit të ndërtimit të objektit.

Nga fondi sigurimit për përgjegjësinë profesionale të mbikëqyrësit, për dëmtime të ndodhura në objekt si pasojë e veprimtarisë së mbikëqyrësit gjatë të ndërtimit të objektit, si:

- a) shembje tërësore ose pjesore të objektit;
- b) rrezik të dukshëm të shembjes së objektit;
- b) defekte serioze/të rënda gjatë procesit të ndërtimit

- **Për raportimin e punimeve të kryera.**

Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te autoriteti kontraktor OST sh.a., çdo **45 (dyzet e pesë) ditë** ose sipas kushteve të kontratës, për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit.

Në këtë raport duhet të përshkruhet qartë ecuria e punimeve (foto + video) situacionet e punimeve, realizimi i punimeve në vleftë dhe % dhe i gjendjes së pagesave të kryera.

Raporti pjesor dhe progresiv që do të shoqërojë situacionet pjesore dhe progresive të pranuar, duhet të përmbajë:

- Informacion i përgjithshëm përfshirë qëllimi investimit
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi
 - Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.
 - Stafi aktual
 - Kohëqëndrimi në objekt për secilin.
- Raportimi teknik të ecurisë dhe gjendjes së objektit
- Progresivin e punimeve
- Fotografi të proceseve të punëve të kryera
- Fotografi të punimeve kryesore të dukshme ose të padukshme.
- Grafiku i ecurisë së punimeve të realizuara
- Volumet Progresive të Punimeve Mijore.
 - a - Punimet e miratuara
 - b - Certifikatat e cilësisë dhe testet Laboratorike
 - c - Libreza e Masave me punimet e kryera në fakt të miratuara ose të aprovuara
 - d- Matjet topografike
- Korrespondenca ndërmjet palëve
 - Proçes – verbale
 - Urdhëresa, Udhëzime, Njoftime
 - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv, nëse ka.

Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga autoriteti kontraktor.

Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit dhe situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin. (shih VKM nr. 610, dt. 22.09.2022)

- **Dokumentacioni Teknik i Mbikëqyrësit (dosja)**

Mbikëqyrësi i punimeve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i punimeve, merr nga zbatuesi i punimeve deklaratën teknike për punimet e kryera, e cila nënshkruhet nga drejtuesit teknik e ligjorë të zbatuesit të punimeve, si dhe përgjegjësi teknik i punimeve në kantier, bazuar në dokumentacionin teknik të grumbulluar dhe të përpunuar në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve

Mbikëqyrësi i punimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim nga zbatuesi i punimeve për përfundimin e punimeve, nëse nuk i vihet në dispozicion, i kërkon zbatuesit të punimeve dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Kontratën dhe aktet që lidhen me të.
- b) Regjistrin e kontabilitetit;
- c) Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve;
- ç) Çertifikatat e cilësisë së provave të materialeve të përdorura gjatë procesit të ndërtimit, të lëshuara nga laboratorët e akredituar për këtë qëllim;
- d) Për materiale të importuara, certifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Evropian;
- dh) Deklaratën që vërteton se objekti është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, si dhe në përputhje me kushtet teknike në fuqi.
- e) Deklaratën që vërteton se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara, nëse ka pasur.

Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me drejtuesin e punimeve në përfundim të punimeve përgatit dokumentacionin e nevojshëm për kolaudim dhe së bashku me relacionin përfundimtar ia vendos në dispozicion autoritetit kontraktor.

Në përgatitjen për kolaudim mbikëqyrësi i punimeve kryen **mbikëqyrjen përfundimtare**, që konsiston në:

- ✓ Përputhshmërinë e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Kontrollin në objekt për të verifikuar, nëse ka defekte, të cilat janë brenda afatit të garancisë. Nëse konstaton defekte, kërkon nga zbatuesi i punimeve korrigjimin e tyre, duke përcaktuar një afat kohor, në përputhje me llojin e defektit, para skadimit të afatit të garancisë kontraktuale ose të paktën në dy vitet e para pas pranimit të përfundimeve të punimeve;
- ✓ Mbledhjen e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatin përfundimtar të projektit të zbatuar;
- ✓ Përgatitjen e raporteve për gjendjen e objektit në bazë të gjetjeve nga kontrolli për aftësinë funksionuese të pjesëve të objektit dhe të objektit në tërësi;
- ✓ Hartimin e listës për pajisjet dhe inventarin;
- ✓ Përgatitjen e udhëzimeve për mirëmbajtjen dhe kujdesin e objektit, për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit;
- ✓ Mbikëqyrjen e punimeve të mirëmbajtjes për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit, por jo më shumë se 2 (dy) vjet;
- ✓ Verifikimin e analizës së ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij, shpenzimeve dhe defekteve;
- ✓ Konfirmimin se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara.

Dosja teknike e objektit do të përmbajë:

1. Lejen e zhvillimit, lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi kompetent.
2. Njoftimi/Proçes- verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
3. Njoftimi/Proçes- verbalin për fillimin e punimeve.
4. Kontratën e lidhur ndërmjet kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, OST-sha.
5. Çertifikatat profesionale (liçensat) të pjesëmarrësve në proçesin e ndërtimit.
6. Kontratën e lidhur ndërmjet shoqërisë mbikqyrëse me Autoritetin Kontraktor, OST-sh.a.
7. Projekt organizimin e punimeve.
8. Projekt-Zbatimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor
9. Preventivin e ofertes fituese
10. Grafikon e punimeve ne perputhje me afatet dhe kushtet e kontratës
11. Aktin e miratimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, miratuar nga organi kompetent
12. Specifikimet teknike të përfshira në kontratë.
13. Azhornimi para fillimit të punimeve dhe piketimi i objektit.
14. Dokumentacioni topografik dhe aktin e piketimit të objektit dhe studimin gjeologjor inxhinierik.
15. Studimin sizmik
16. Ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre, si dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të gjitha problemet e verifikuara, të miratuara dhe të firmosura nga ai.
17. Aktet e miratimit në fushën e trashëgimisë kulturore, arkeologjike apo zonat e mbrojtura mjedisore, sipas legjislacionit sektorial në fuqi (për projektet e linjave të tensionit të lartë)
18. Dokumentacionin fotografik apo videoregjistrimin për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, punimet e maskuara.
19. Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi i punimeve të shoqëruar me fotot përkatëse.
20. Ditari i objektit, ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi, gjatë zbatimit
21. Librezat e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e punimeve për të gjitha punimet. Për punimet civile, volumet të shoqërohen me skica dhe faktorët gjeometrike (gjerësi, gjatësi, lartësi). Libreza e masave është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.
22. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe provat laboratorike të materialeve të përdorur në objekt.
23. Miratimi i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi i punimeve.
24. Çertifikatat e garancise dhe konformitetit për pajisjet.
25. Çertifikimin e montimit të pajisjeve elektrike dhe inspektimi final te tyre.
26. Situacionet mujore pjesore dhe progressive, të hartuara mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit.

27. Faturat e blerjeve te kontraktorit dhe regjistri i kontabilitetit të shpenzimeve.
28. Aktet e inspektimit të kryera gjatë zbatimit të punimeve.
29. Aktin e kontrollit të përfundimtar të objektit.
30. Siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike.
31. Policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale.
32. Deklarata teknike në përfundim të punimeve e kontraktorit e firmosur nga drejtuesi teknik i kontraktorit, inxhinieri i objektit të punimeve dhe drejtuesi ligjor kontraktorit.
33. Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.
34. Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe paisjen me mjete mbrojtëse përkatëse. Proces-verbalet me firmat e personelit të zbatimit në terren për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, për të gjitha llojet e punimeve (nga hapja e gropave të bazamenteve deri tek punimet e izolacionit të TL)
35. Dokumentin e vlerësimit të rrezikut, (sipas Vendimit nr. 312 dt 05.05.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK).
36. Raportimet pjesore, 45 ditore (ose sipas kontrates) të bëra pranë Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe autoritetit të lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Autoritetit kontraktor OST sh.a.
37. Proçes- verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga kontraktori dhe mbikëqyrësi
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 21 punonjes te punesuar-Muaji Tetor 2025 20 punonjes te punesuar-Muaji Nentor 2025 20 punonjes te punesuar-Muaji Dhjetor 2025 <u>Profili i punonjësve:</u> 1. XXXXX, me vendlindje në Gostivisht, banues ne Tirane, me datëlindje 23.03.1953, dhe me Nr. Personal XXXXX sipas kartës bashkëngjitur: me profesion Inxhinier Ndërtimi Civile-Industriale-Ura punësuar pranë shoqërisë sonë me kontratë individuale pune nr. Repertori XXXXX dhe nr. Koleksioni XXXXX datë 14.06.2024, në rolin Drejtues Teknik Inxhinier Ndërtimi Civile-Industriale-Ura, Mbajtes i diplomes Nr. XXXXX B, leshuar nga Fakulteti i Inxhinierise, Universiteti i Tiranës, Numer regjistri diplome XXXXX, mbajtës i licensës në mbikëqyrje dhe kolaudim nr. MK. XXXXX me Titull Ing. Ndërtimi, Civile-Industriale-Ura lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. 2. XXXXX, me vendlindje në Durrës, banuese ne Tirane, me datëlindje 10.07.1978, dhe me Nr. Personal XXXXX sipas kartës bashkëngjitur: me profesion Inxhinier Elektrik, punësuar pranë shoqërisë sonë me kontratë individuale pune nr. Repertori XXXXX dhe nr. Koleksioni XXXXX datë 17.01.2022, në rolin Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik, Mbajtes i diplomes Nr. XXXXX leshuar nga Fakulteti i i Inxhinierise Elektrike, Universiteti Politeknik i Tiranës, Numer regjistri diplome XXXXX,mbajtës i licensës në mbikëqyrje dhe kolaudim nr. MK. XXXXX me Titull Ing. Elektrik Drejtimi Energjitik lëshuar nga Ministria e
---	---

	<i>Infrastrukturës dhe Energjisë.</i> 3. XXXXX, me vendlindje në Shkoder, banues ne Shkoder, me datëlindje 18.01.1956, dhe me Nr. Personal XXXXX sipas kartës bashkëngjitur: punesuar prane shoqerise sone me kontrate individuale pune nr. Repertori XXXXX dhe nr. Koleksioni XXXXX date 30.11.2022, ne rolin Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik, Mbajtes i diplomes Nr. XXXXX, leshuar nga Fakulteti i i Inxhinierise Mekanike dhe Elektrike, Universiteti i Tiranes, dega Mekanike, Numer regjistri diplome XXXXX ,mbajtes i licenses ne mbikqyrje dhe kolaudim nr. MK. XXXXX me Titull Ing. Mekanik Industrial leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise. <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1- 2 (dy) Pajisje GPS në pronësi të Grama Shpk sipas faturës tatimore të blerjes nr. XXXXX datë 29.10.2018 serial XXXXX dhe nr. XXXXX datë 30.11.2018 serial 3 XXXXX. 2- 1 (një) pajisje Total Station me qera sipas kontratës nr. XXXXX Rep. nr. XXXXX Kol. date 24.06.2022. 3- 1(një) autoveture 4x4 TOYOTA RAV4 i vitit 2014 me targe XXXXX ngjyre e zeze me leje qarkullimi Nr. T XXXXX. _____ —
Emri, Mbiemri Arjola Mazari Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 14.06.2024, të lidhur midis punëdhënësit "GRAMA" SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet "Drejtues teknik" me afat 10-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

"1. Qershor 2023-Vazhdim Projektues /Inxhinier Hidroteknik/Inxhinier Mbikqyrës Punimesh prane kompanise "GRAMA" SHPK

2. 2000-2017 Person Fizik XXXXX

3. 2002-2007 Inxhinier Zbatues / Drejtues Teknik prane kompanise "MARKO-CO" SHPK

4. 2000-2002 Inxhinier Zbatues / Drejtues Teknik prane kompanise "AREELA" SHPK

5. 1998-2000 Kryeinxhinier, Ndermarja e Ujrave Permet

6. 1994-1998 Shef urbanistike, Bashkia Permet

7. 1984-1994 Kryeinxhinier Ndermarja e Ndertimit Ushtarake

8. 1977-1984 Inxhinier zbatimi, Ministria e Mbrojtjes

9. 1976-1977 Inxhinier projektues, Instituti e Projektimit te Veprave Mbrojtes

10. Korrik 1972- Korrik 1977 Teknik I mesem, Ndermarrja e Bonifikimit Korce

11. Shtator 2011-Vazhdim Inxhinier Projektues /Mbikqyrës Punimesh (Konsulent I Jashtem) prane kompanise "ANGERBA" SHPK".

- Diplomë nr. XXXXX, datë 15.05.1977 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli "Inxhinier për ndërtim civil-industriale-ura".

- Licensë nr: XXXXX, datë 25.06.2024 "Në Projektim" për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Licensë nr: MK XXXXX, datë 25.06.2024 "PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT" për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 17.01.2022, të lidhur midis punëdhënësit "GRAMA" SHPK dhe punëmarrëses znj. XXXXX, i cili punësohet "Drejtues teknik" me afat 10-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të znj. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

"1. Janar 2022-Vazhdim Projektues /Inxhinier Elektrik prane kompanise "GRAMA" SHPK

2. 2006-2012 Inxhinier Elektrik (Konsulent I Jashtem) prane kompanise "Zenit&Co" SHPK

3. Shtator 2021-Janar 2022 Inxhinier Elektrik (Konsulent I Jashtem) prane kompanise "AMCO ENGINEERING" SHPK

4. Shkurt 2018-2020 Inspektore, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

5. Qershor 2015- Shkurt 2018 Koordinatore Departamenti i Inovacionit dhe Mirëqeverisjes Njësia e Komunikimeve Elektronike, Postare dhe Integritimit

6. Shkurt 2010 – Qershor 2015 Specialiste për shërbimet postare, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)

7. Gusht 2005- Shkurt 2010 Specialiste e Postë-Telekomunikacionit, Ministrinë e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit".

- Diplomë nr. XXXXX, datë 15.05.1977 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ku dëshmohet se znj. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier elektrik drejtimi ‘Energjitikë’.”.
- Licensë nr: XXXXX, datë 10.05.2021 “Në Projektim” për znj. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Licensë nr: XXXXX, datë 23.06.2022 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për znj. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 30.11.2022, të lidhur midis punëdhënësit “GRAMA” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX XXXXX, i cili punësohet “Inxhinier mekanik” me afat 10-vjeçar.
- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:
 - “1. 2023– vazhdim Projektues Inxhinier Mekanik/ Inxhinier Supervizor prane kompanise Zenit&Co” SHPK
 2. 2022– vazhdim Projektues Inxhinier Mekanik/ Inxhinier Supervizor prane kompanise “GRAMA” SHPK
 3. 2019 Nentor 2021 Inxhinier Projektues/Inxhinier Supervizor prane kompanise “AMCO ENGINEERING” SHPK
 4. 2017-2019 Inspektore, Inxhinier Mekanik, prane kompanise “ANGERBA” SHPK
 5. 2007-2021 Mesues Shkolla e mesme industriale “Arben Broci”
 6. 2000-2005 Inxhinier Mekanik/ Inxhinier Supervizor prane kompanise “B.S.K” SHPK
 7. 1991-1992 Inxhinier mekanik, N.N. Banesa Shkoder
 8. 1987-1991 Inxhinier mekanik, N.B. Velipoje
 9. 1979-1987 Axhustator Reparti Kimise Reparti Ushtarak 6286, Vau Dejes, Shkode
 10. 1977-1979 Ushtar radist nderlidhje Reparti ushtarak 8001, Shkoder
 11. 1975-1976 Axhustator NSHN, HC K. Çimentimit Fierze”.
- Diplomë nr. XXXXX, datë 06.02.1985 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier mekanik industrial”.
- Licensë nr: XXXXX datë 27.09.2023 “Në Projektim” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Licensë nr: XXXXX, datë 27.11.2024 “Në Projektim” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Licensë nr: XXXXX, datë 28.07.2022 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Licensë nr: XXXXX, datë 27.11.2024 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 30.11.2022, të lidhur midis punëdhënësit “GRAMA” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet “Inxhinier mekanik” me afat 10-vjeçar.
- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:
 “1. 2023– vazhdim Projektues Inxhinier Mekanik/ Inxhinier Supervizor prane kompanise Zenit&Co” SHPK
 2. 2022– vazhdim Projektues Inxhinier Mekanik/ Inxhinier Supervizor prane kompanise “GRAMA” SHPK
 3. 2019 Nentor 2021 Inxhinier Projektues/Inxhinier Supervizor prane kompanise “AMCO ENGINEERING” SHPK
 4. 2017-2019 Inspektore, Inxhinier Mekanik, prane kompanise “ANGERBA” SHPK
 5. 2007-2021 Mesues Shkolla e mesme industriale “Arben Broci”
 6. 2000-2005 Inxhinier Mekanik/ Inxhinier Supervizor prane kompanise “B.S.K” SHPK
 7. 1991-1992 Inxhinier mekanik, N.N. Banesa Shkoder
 8. 1987-1991 Inxhinier mekanik, N.B. Velipoje
 9. 1979-1987 Axhustator Reparti Kimise Reparti Ushtarak 6286, Vau Dejes, Shkode
 10. 1977-1979 Ushtar radist nderlidhje Reparti ushtarak 8001, Shkoder
 11. 1975-1976 Axhustator NSHN, HC K. Çimentimit Fierze”.
- Diplomë nr. XXXXX, datë 06.02.1985 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier mekanik industrial”.
- Licensë nr: XXXXX, datë 27.09.2023 “Në Projektim” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Licensë nr: XXXXX, datë 28.07.2022 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

F) Ofertuesi “A & E Engineering” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimet “Shtojca OST”, “Stafi 1-OST”, “Stafi 2-OST”, ku ndër të tjera ka dorëzuar Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, diplomat, Jetëshkrimet dhe kontratat e punës dhe të bashkëpunimit, si më poshtë vijon:

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “A & E Engineering” SHPK, ku në Pjesën III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i> <i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i>	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 35 të punësuar (Disponoj numrin minimal 20 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit të kërkuara sipas DST-së) <u>Profili i punonjësve:</u> <u>1. Inxhinier Ndertimi</u> - XXXXX (Licence Mbikqyrje MK XXXXX Diplome Nr. XXXXX Fakulteti i Inxhinierise Universiteti i Tiranes, Dega Ndertim me titull Inxhinier Ndertimi. Kontrate Pune. CM <u>2. Inxhinier Elektronik</u> - XXXXX (Licence Mbikqyrje MK. XXXXX, Diplome Nr. XXXXX Fakulteti i Inxhinierise Elektrike Universiteti Politeknik Tirane Dega Elektronike me titull Inxhinier Elektronik Drejtimi Telekomunikacion, Kontrate Pune, CV) <u>3. Inxhinier Elektrik</u> - XXXXX (Licence Mbikqyrje MK XXXXX, Diplome Nr. XXXXX Fakulteti Inxhinierise Universiteti Shteteror i Tiranes, Dega Elektrike me titull Inxhinier Elektrik me Specialitet Rryma te dobta, Kontrate Pune, CV) <u>4. Inxhinier Mekanik</u> - XXXXX (Licence Mbikqyrje MK. XXXXX, Diplome Nr. XXXXX B.Fakulteti i Inxhinierise Universiteti i Tiranes. Dega Mekanike me titull Inxhinier Mekanik per Transport - Bujqesi, Grade Shkencore *Doktor*/Nr. XXXXX Kontrate Pune, CV) <u>5. Inxhinier Miedisi</u> - XXXXX (Licence Mbikqyrje MK.4373.Diplome Nr. XXXXX Fakulteti i Inshinierise se Ndertimit Universiteti Politeknik Tirane ne degen Mjedis me titull Inxhinier Mjedis Profili Trajtimi i Lirave, Kontrate Pune, CV) <u>6. Inxhinier Gieodet</u>
---	---

	- XXXXX (Licence Mbikqyrje MK XXXXX 1, Diplome Nr. XXXXX Fakulteti Inxhinierise Universiteti i Tiranës në degën Geodezi me titull Inxhinier Gjeodet, Certificate ArcGIS date 22.09.2003 Kontrate Pune, CV) <u>7. Inxhinier Gjeolog</u> - XXXXX (Licence Mbikqyrje Mk. XXXXX, Diplome Nr. XXXXX Fakulteti Gjeologii - Miniera. Universiteti Politeknik Tirane, Dega Gjeolleji me titull Inxhinier Gjeolog, Kontrate Pune, CV) <u>Makinëri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____ — ----- _____
Emri, Mbiemri E. C _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 16.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “A & E Engineering” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet “Drejtuës teknik” me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

“1. 1993 - 2009 (Inxhinier Ndertimi / Projektim dhe Zbatim në fushën e Ndertimit, Sipërmarrës privat për ndertime dhe projekte)

2- 1986 - 1993 (Inxhinier Ndertimi , Ndermarrje Projektimi)

3- 1980 - 1986 (Inxhinier Ndertimi , Ndermarrje Ushtarake)

4- 1979 - 1980 (Inxhinier Ndertimi , Ndermarrja e Ujerave)”.

- Diplomë nr. XXXXX, datë 24.01.1979 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier ndërtimi”.

- Licensë nr: XXXXX, datë 30.03.2017 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 24.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “A & E Engineering” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet “Drejtues teknik” me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

“1. Tetor 2005 – Janar 2006 (Specialist IT, prane kompanise ""Ccs Hardëare and Softëare Service"" SHPK)

2. Janar 2006 – Mars 2008 (Specialist IT, prane kompanise ""Lottospert"" SHPK)

3. Mars 2008 – Gusht 2015 (Inxhinier Projektues/Mirembajtes, Televizioni kabllor Korçe, Bul Shen Gjergji)

4. Shtator 2009 – Vazhdim (Pedagog, Universiteti “F.S Noli”, Korçe)

5. Shtator 2015 – Qershor 2016 (Mesues, Shkolla e Mesme Profesionale Tik “F.S.Noli”, Korçe)

6. Shtator 2016 – Vazhdim (Mesues, Shkolla e Mesme Profesionale Tik “Demir Progri”, Korçe)

7. 2019 – Vazhdim (Inxhinier Elektronik – Ekspert i jashtem)

8. Shkurt 2022 – Inxhinier me kohe te plote “A&E Engineering” sh.p.k, Tirane ”.

- Diplomë nr. XXXXX, datë 14.07.2006 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier elektronik, drejtimi ‘Telekomunikacion’”.

- Licensë nr: MK. XXXXX datë 31.01.2022 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 23.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “A & E Engineering” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet “Drejtues teknik” me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

“1. 2018 – 2024 (Asistent I jashtem, Inxhinier Elektrik ne Shoqerine “A&E Engineering” sh.p.k)

2- 2024 – ne vazhdim (Inxhinier Elektrik ne Shoqerine “A&E Engineering” sh.p.k)

3- 1973 - 1994 (Pjese e Ushtrise)

4- 1994 - 2001 (Inxhinier elektrik, TEC Fier)

5- 2001-2003 (Punonjes ne D.P. Postare)”.

- Diplomë nr. XXXXX, datë 30.07.1973 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier elektrik me specialitet ‘Rryma të dobëta’”.

- Licensë nr: XXXXX, datë 29.07.2024 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 12.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “A & E Engineering” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet “Drejtues teknik” me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

“1. 2010 – Vazhdim (Pedagog prane Fakultetit te Inxhinierise Mekanike Departamenti i Mekanikes dhe mjeteve levizese.)

2. 2006 – 2010 (Pergjegjes i parkut te mjeteve te ndertimit dhe transportit I.C.G Maltaura Vicenca Itali Kantjeri ne Shqipe)

3. 2005 – 2006 (Drejtor i Drejtorise se sherbimit te mjeteve hekurudhore Durres)

4. 2002 – 2005 (Kryespecialist ne departamentin e transportit udhetare prane Drejtorise se pergjitheshme te Hekurudhave)

5. 1998 – 2002 (Drejtor i Drejtorise se sherbimit te mjeteve hekurudhore Durres)

6. 1996 – 1998 (Kryetar i Deges Teknike te ne bazen mekanike te hekurudhes)

7. 1994 – 1996 (N/Drejtor i Drejtorise Rajonale hekurudhore Fier (me juridiksion Golem I Kavajes -Vlore))

8. 1992 – 1994 (Drejtor i Parkut te mjeteve Hekurudhore)

9. 1984 – 1988 (Inxhinier i repartit te vagonave)”.

- Diplomë nr. XXXXX, datë 27.05.1983 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier mekanik për transport bujqësi”.

- Licensë nr: MK. XXXXX, datë 28.07.2022 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 12.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “A & E Engineering” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet “Drejtues teknik” me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklarohet eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

“1. Nga 2019 – 2024 (Inxhinier Mjedisi, si ekspert i jashtem ne Shoqerine “A&E Engineering” sh.p.k)

2. Nga 2024 e ne vazhdim (Inxhinier Mjedisi ne Shoqerine “A&E Engineering” sh.p.k)

3. 2009 – ne Vazhdim (Inxhinier i lire Inxhinier Mjedisi (Projektim, Mbikqyrje&Kolaudim))

4. 2012 - vazhdim (Bashkia Tirane Inxhinier Mjedisi Pjese e grupit te projektimit dhe kontrollit te projekteve.)

5. 2009 - 2012 (Inxhinier Mjedis, Dega Teknike, Ujesjellesi Elber sh.p.k, Elbasan)”.

- Diplomë nr. XXXXX, datë 06.04.2009 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli “Inxhinier mjedisi, profili ‘Trajtim I ujrave’”.

- Licensë nr: XXXXX, datë 05.06.2024 “PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT” për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 13.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “A & E Engineering” SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX e cila punësohet “Drejtues teknik” me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) të z. XXXXX ku deklarohet eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

“1. Nga 2015 – 2020 - (Inxhinier Gjeologe - Eksperte e jashtme ne shoqerine “A&E Engineering” sh.p.k)

2. (Nga 2020 e ne vazhdim (Drejtuese Teknike - Inxhinierë Gjeologë ne Shoqëri "A&E Engineering" sh.p.k)).

- Diplomë nr. XXXXX, datë 01.03.2009 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli "Inxhinier mjedisi, profili 'Trajtim I ujërave'".

- Licensë nr: XXXXX, datë 30.04.2024 "PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT" për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Kontratë pune noteriale nr. XXXXX rep, datë 21.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit "A & E Engineering" SHPK dhe punëmarrëses z. XXXXX, i cili punësohet "Drejtues teknik" me afat 5-vjeçar.

- Jetëshkrim (CV-i) z. XXXXX ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

"1. (Nga 2020 e ne vazhdim (Inxhinier Gjeodet/Drejtues Teknik ne Shoqëri "A&E Engineering" sh.p.k)

2. Nga 2016 – 2020 (Inxhinier/Ekspert i jashtëm pranë shoqërisë "A&E Engineering" sh.p.k ne fushën e gjeodezisë ne projekte te ndryshme)

3. 1980 - 1981 (Inxhinier/Specialist Gjeodet, Drejtoria e Ujërave dhe Sistemeve Gjyrokaster)

4. 1981 - 1989 Inxhinier Gjeodet, Ndermarrje Bujqësore)

5. 1989 - 1992 (Inxhinier Gjeodet, Komiteti Ekzekutiv i Kadastres Gjyrokaster)

6. 1995 - 2008 (Inxhinier gjeodet, Bashkia Gjyrokaster)

7. 2008 - 2011 (Specialist/Inxhinier Topograf, ZVRPP Gjyrokaster)

8. 2013 - 2016 (Ekspert I proceseve bujqësore Gjyrokaster)".

- Diplomë nr. XXXXX, datë 26.05.1980 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XXXXX i jepet titulli "Inxhinier gjeodet".

- Licensë nr: XXXXX, datë 19.01.2020 "PËR MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT" për z. XXXXX, lëshuar nga Komisioni i Posacëm i Dhënies së Licensave Profesionale në Fushën e Projektimit dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

PËR KRITERIN KUALIFIKUES TË PËRCAKTUAR NË PIKËN 2.3.8 "KAPACITETI TEKNIK":

A) Ofertuesi "NET-GROUP" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin "Qasja_Metodologjia_Plani_i_Punës_MK_OST_25 (1)",

B) Ofertuesi "ERALD-G" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin "13_METODOLOGJIA_OST",

"14_PLANI_I_PUNES_DHE_GRAFIKU_I_DOREZIMIT_TE_PROJEKTIT"

"15_MOBILIZIMI_ORGANIZIM_I_STAFIT"

C) Ofertuesi "ARENA MK" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin "304_Propozimi_TEKNIK"

D) Ofertuesi "Civil Cons" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin "F_Metodologji_OST_JANAR_2026_"

E) Ofertuesi “ZENIT&CO” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin “METODOLOGJIA_OST”

F) Ofertuesi “A & E ENGINEERING” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin “Metodologjia_OST”

III.1.8. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” ShPK autoriteti kontraktor me shkresën shkresën nr. 2837/1 prot, datë 28.04.2026 me objekt “Kthim përgjigjre shkresës Nr. 947/5 prot, datë 23.04.2026” protokolluar me tonën me nr. 947/6 prot, datë 30.04.2026 ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik procesverbalin e vlerësimit të ofertave të paraqitura i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03..2026, ku pasqyrohet se si është bërë vlerësimi me pikë i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë “NET-GROUP” SHPK, “ERALD-G” SHPK, “ARENA MK” SHPK, “CIVIL CONS” SHPK, “ZENIT&CO” SHPK dhe “A & E ENGINEERING” SHPK referuar kriterit të vlerësimit në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Nr	OE/BOE ofertues	Oferta pa TVSH	Çmimi [0-50] pikë	Metodologjia e propozuar [0-30] pikë	Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar [0-10] pikë	Përvoja për punë të ngjashme [0-10] pikë	Totali I pikëve	Komente per vleresimin e kontratave te ngjashme (Perlllogaritja 5 pike per punime civile dhe 5 pike per punime elektrike te ngjashme me ato te AK)
5	OE "NET-GROUP" sh.p.k	26.465.686,52	XX	XX	XX	XX	XX	XX
6	OE "ERALD-G" sh.p.k	26.770.000	XX	XX	XX	XX	XX	XX
14	BOE "ARENA MK" sh.p.k & "HTS Company" SH.P.K	29.083.172	XX	XX	XX	XX	XX	XX
14	BOE "ZENIT&CO" sh.p.k & "GRAMA" SH.P.K	29.083.172	XX	XX	XX	XX	XX	XX
1	OE "CIVIL CONS" sh.p.k	27.629.013,4	XX	XX	XX	XX	XX	XX

14	OE "A & E ENGINEERING" SH.P.K	25.593.191,4	XX	XX	XX	XX	XX	XX
----	-------------------------------------	--------------	----	----	----	----	----	----

Në lidhje me kriterin e metodologjisë, KVO argumenton pikëzimin e dhënë sipas tabelës së mëposhtme:

OE/BOE ofertues	Kommente per Metodologjine
OE "NET-GROUP" sh.p.k	XX
OE "ERALD-G" sh.p.k	XX
OE "CIVIL CONS" sh.p.k	XX
BOE "ARENA MK" sh.p.k & "HTS Company" SH.P.K	XX

OE "A & E ENGINEERING" SH.P.K	XX
BOE "ZENIT&CO" sh.p.k & "GRAMA" sh.p.k	XX

III.1.9. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.10. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.11. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.

III.1.12. Në nenin 52 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasisë të parashikuara. Afati i marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se 4 vjet. Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektoriale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 vjet.

2. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj. Këto kontrata mund të zbatohen vetëm ndërmjet atyre autoriteteve ose enteve kontraktore që janë identifikuar qartë për këtë qëllim në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi dhe atyre operatorëve ekonomikë që janë palë të marrëveshjes kuadër që është lidhur. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër në asnjë rrethanë nuk mund të përfshijnë ndryshime thelbësore të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e përmendur në pikën 3 të këtij neni.

3. Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës.

4. Kur marrëveshja kuadër lidhet me më shumë se një operator ekonomik, atëherë kjo marrëveshje kuadër zbatohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin;

b) kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë, pjesërisht pa rihapur konkurrimin në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike, dhe pjesërisht me rihapjen e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, në përputhje me shkronjën “c” të kësaj pike, kur kjo mundësi është parashikuar nga autoritetet ose entet kontraktore në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Zgjedhja nëse punët, furnizimet ose shërbimet specifike blihen pas rihapjes së konkurrimit ose direkt sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër bëhet në përputhje me kritere objektive, të cilat përcaktohen në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Në këto dokumente duhet, gjithashtu, të specifikohet se cilat kushte mund t’i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit. Mundësitë që parashikohen në paragrafin e parë të kësaj shkronje, gjithashtu, zbatohen për çdo lot të marrëveshjes kuadër, për të cilët të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë përcaktohen në marrëveshjen kuadër, pavarësisht nëse janë përcaktuar ose jo të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e këtyre punëve, shërbimeve dhe furnizimeve për lote të tjera.

c) kur në marrëveshjen kuadër, nëpërmjet rihapjes së konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, nuk janë përcaktuar të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve.

5. Konkurrimet e përmendura në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 4 bazohen në të njëjtat kushte që zbatohen për dhënien e marrëveshjes kuadër dhe, nëse është e nevojshme, në bazë

të kushteve të formuluar më saktësisht dhe, sipas rastit, në kushte të tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në përputhje me procedurën në vijim:

- a) për çdo kontratë që do të prokurohet, autoritetet ose entet kontraktore komunikojnë me shkrim ose me mjete elektronike me palët në marrëveshjen kuadër;
- b) autoritetet ose entet kontraktore duhet të caktojnë një afat jo më pak se 2 ditë për dorëzimin e ofertave për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit që do të prokurohet dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat;
- c) ofertat do të dorëzohen me shkrim ose me mjete elektronike dhe përmbajtja e tyre duhet të mbetet konfidenciale, derisa kufiri i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar;
- ç) autoritetet ose entet kontraktore do t'i japin kontratën ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kriterëve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit të marrëveshjes kuadër.”.

III.1.13. Në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret e tilla mund të përfshijnë:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;
- b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose
- c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

- a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose
- b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të

vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.”.

III.1.14. Në nenin 92 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”.

III.1.15. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter

dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet V_{mink1} Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është: Oferta më e mirë = X + Y

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;

ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;

iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kriterëve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për propozimin ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$ (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).”.

III.1.16. Në nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit. Në rastin e prokurimit të kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.

2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.

Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e komisionit të vlerësimit të ofertave. Përfundimisht, nëse komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t'i propozojë titullarit anulimin e procedurës.

Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.”.

III.1.17. Në nenin 80 “Hapja e ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat në përputhje me nenin 90, të LPP-së, dhe me përcaktimet në këto rregulla.

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

3. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit, mund të jetë i pranishëm gjatë fazës së hapjes së ofertave duke kryer funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

4. Në rastin kur procedura zhvillohet në formë shkresore, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më pas, lexohet me zë të lartë oferta ekonomike dhe lista e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikuese të paraqitura nga ofertuesi. Procesverbali dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t'i vihet në dispozicion në bazë të kërkesës çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesve që kanë paraqitur ofertë, por që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'u dërgohet njoftim për hapjen e procedurës.

Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit. Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

5. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të dokumentohet. 6. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 21, të LPP-së.”.

III.1.18. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/ve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

b) nëse ka ndonjë mospërputhje të çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është, si më poshtë vijon:

O – Oferta MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme MO = O1 + O2 + O3 + ... On/N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.”.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/et e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

5. Në rastin e procedurave të prokurimit me fazë, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 58, të LPP-së.

Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik.

Në varësi të llojit të procedurës së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, në varësi të kompleksitetit të kontratës, mund të zhvillojë negociata në fazë të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës.

Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal.

Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit.

Në rastin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, afatet për vlerësimin e ofertave përcaktohen nga autoriteti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të kontratës dhe situatës konkrete.

6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.”.

III.1.19. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur

operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit të nenit 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.”.

III.1.20. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme;
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së;
- në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”.

III.1.21. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.22. Në rastin konkret, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të ofertës së dorëzuar prej tij në këtë procedurë prokurimi, si dhe përsa i përket vlerësimit me pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “NET-GROUP” SHPK, të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “ERALD-G” SHPK, të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “ARENA MK” SHPK, të

ofertës së operatorit ekonomik ofertues “CIVIL CONS” SHPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “ZENIT&CO” SHPK, Komisioni i Prokurimit Pubik konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka përcaktuar si metodologji për përcaktimin e ofertës fituese metodën “Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto”, duke përcaktuar 4 (katër) kriteret të përzgjedhjes së ofertës fituese dhe konkretisht, si në vijim: “Kriterin “Çmimi” duke e peshuar me 0-50 pikë; Kriterin “Metodologjia e propozuar” duke e peshuar me 0-30 pikë, Kriterin “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar” duke e peshuar me 0-10 pikë, si dhe Kriterin “Përvoja për punë të ngjashme” duke e peshuar me 0-10 pikë”, ndërkohë që nuk ka publikuar një metodologji lidhur me vlerësimin me pikë për Kriterin “Metodologjia e propozuar”, për Kriterin “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar” dhe për Kriterin “Përvoja për punë të ngjashme”. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT të dokumenteve të tenderit ka përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, ku operatorët ekonomikë ofertues përpara se të vlerësohen me pikë duhet që fillimit të kualifikohen, pra duhet që të plotësojnë këto kriteret kualifikuese, ku ndër kriteret e veçanta të kualifikimit janë dhe kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” dhe në pikën 2.3.8 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT të këtyre dokumentave dhe vetëm pas përmbushjes së këtyre kriterëve ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues do të vlerësohen me pikë për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, ndërkohë që në rastin kur nuk plotësojnë kriteret kualifikuese atëherë ofertat e paraqitura nga këta oferatorë ekonomikë do të skualifikohen dhe do të vlerësohen me 0 (zero) pikë.

Në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme me shërbimet objekt prokurimi në vlerën 10.000.000 lekë ppa TVSH, pra këto shërbime duhet të jenë realizuar në periudhën nga data 30.12.2025 (Data e shpalljes së procedurës së prokurimit) deri në datën 30.12.2022 (afat i fundit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit), ku këto shërbime të ngjashme mund të jenë realizuar me ente publike ose me sektorin privat, ndërkohë që në rastin e realizimit të shërbimeve me ente publike autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kontratën e lidhur me entin publik të shoqëruar me vërtetim të lëshuar nga enti publik që dëshmon realizimin me sukses të kontratës ose faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohet data, shuma dhe shërbimi i realizuar, ndërsa në rastin e shërbimeve të ngjashme të realizuara në sektorin privat operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohet data, shuma dhe shërbimi i realizuar.

Në rastin kur operatorët ekonomikë ofertues ofertojnë si bashkim operatorësh ekonomikë, (sipas parashikimeve të nenit 14 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar) duhet që të paraqesin kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë përcaktuar pjesa e shërbimit që do të realizojë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi dhe përsa i përket plotësimit të kriterit kualifikues të në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë duhet të paraqesi kontrata të ngjashme ose fatura tatimore shitje të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se përqindja e marrë përsipër për të realizuar në raport me vlerën e shërbimeve të ngjashme të përcaktuara në këtë kriter kualifikues nga ana e autoritetit kontraktor (sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).

Për me tëpër, referuar përcaktimeve në bërë nga autoriteti kontraktor në në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues pasi të kenë plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit do të vlerësohen me pikë për kriterin e vlerësimit “Përvoja për punë të ngjashme” nga 0 (zero) pikë deri në 10 (dhjetë) pikë, ku vlera ose natyra e shërbimeve të ngjashme do të vlerësohet me pikët maksimale.

Në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponojnë në stafin e tyre punonjësit e kualifikuar si në vijim: “1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacion/IT; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Mjedisi; 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Gjeodet/Topograf”, ku në rastin kur këta punonjës të kualifikuar janë të punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues atëherë duhet të paraqesë formularin e vetë deklarimit, diplomën përkatëse dhe kontratën e punës, si dhe listëpagesat e 3 (tre) muajve të fundit (të muajit shtator 2025, tetor 2025 dhe nëntor 2025, pasi procedura është publikuar në datën 30.12.2025) ku punonjësit duhet të figurojnë të siguruar në këto listëpagesa, ndërsa në rastin kur punonjësit e kualifikuar nuk janë të punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues atëherë ofertuesi duhet të paraqesë një kontratë bashkëpunimi noteriale dhe diplomën përkatëse të punonjësit të kualifikuar me të cilin bashkëpunon.

Në rastin kur operatorët ekonomikë ofertues ofertojnë si bashkim operatorësh ekonomikë, (sipas parashikimeve të nenit 14 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar) duhet që të paraqesin kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë përcaktuar pjesa e shërbimit që do të realizojë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi dhe përsa i përket plotësimit të kriterit kualifikues të në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë duhet dëshmojë se disponojnë në stafin e tyre punonjësit e kualifikuar si në vijim: “1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacion/IT; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Mjedisi; 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Gjeodet/Topograf”, në raport me natyrën e shërbimeve të

marara përsipër për tu kryer nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë (sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).

Në rastin kur operatorët ekonomikë ofertues mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera (sipas parashikimeve të nenit 84 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar) atëherë ofertuesi për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit duhet që subjekti tek i kapaciteti i të cilt mbështet të paraqesë Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” dokumentave të tenderit për të vërtetuar se nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, diplomën dhe kontratën e punës të punonjësit të kualifikuar, si dhe duhet që operatori ekonomik ofertues të dëshmojë se 50% të kriterit kualifikues e plotëson vetë (sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar),

Për me tëpër, referuar përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues pasi të kenë plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit do të vlerësohen me pikë për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar” nga 0 (zero) pikë deri në 10 (dhjetë) pikë.

Në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.8 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatori ekonomik ofertues duhet të propozojë “Metodologjinë e mbikëqyrjes”, “Përqasjen Teknike”, “Planin e punës” dhe “Organizimin e stafit për kryerjen e shërbimit”, duke e shprehur sa më qartë mënyrën e organizimit, si dhe elementet e rëndësishëm që duhen pasur parasysh për realizimin e këtij shërbimi.

Për me tëpër, referuar përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues pasi të kenë plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit do të vlerësohen me pikë për kriterin e vlerësimit “Metodologjia e propozuar” nga 0 (zero) pikë deri në 30 (tridhjetë) pikë, ku vlerësimi me pikë do të bëhet duke vlerësuar “Përqasjen teknike” të propozuar, “Metodologjinë” e propozuar, “Planin e punës” të propozuar dhe “Aftësinë organizative” të propozuar.

III.1.23. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “**A & E ENGINEERING**” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të kriterit të vlerësimit të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të kriterit të vlerësimit “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”

të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues “**CIVIL CONS**” SHPK, , të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues “**ARENA MK**” SHPK të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues “**ZENIT&CO**” SHPK referuar dokumentacionit të ofertës të dorëzuar prej tyre në këtë procedurë prokurimi dhe të pasqyruar në pikën III.1.7., të këtij vendimi, si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

III.1.23.1. Lidhur me pretendimi e operatori ekonomik i ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK për vlerësimin me pikët maksimale për kriterin e vlerësimit “*Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar*”, të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Shtojcën 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ku Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” ka deklaruar se ka të puësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijm: “1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacion/IT; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Mjedisi; 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe 1 (një) inxhinier Gjeodet.”, si dhe ka dorëzuar kontratat e punës , diplomat dhe jetëshkrimet e këtyre punonjësve.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni gjykon se operatori ekonomik ofertues në fazën e ofertimit e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit “*Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar*”, të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK është vlerësuar me 10 (dhjetë) pikë, duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi.

Nisur nga pretendimet e ankiuesit, Komisioni gjykon se për këtë kriter vlerësimi operatori ekonomik ankimues “**A & E ENGINEERING**” SHPK ndaj dhe pretendimi i tij nuk qëndron.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmues “**A & E ENGINEERING**” SHPK nuk qëndron.

III.1.23.2. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik i ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “**CIVIL CONS**” SHPK për kriterin e vlerësimit “*Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar*”, të

përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit ka dorëzuar Shtojcën 10 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” ku Seksioni B: “**DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’**” të Pjesës III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” ka deklaruar se ka të puësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijm: “1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacion/IT; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Mjedisi; 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe 1 (një) inxhinier Gjeodet.”, si dhe ka dorëzuar kontratat e punës , diplomat dhe jetëshkrimet e këtyre punonjësve.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni gjykon se operatori ekonomik ofertues në fazën e ofertimit e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues “**CIVIL CONS**” SHPK është vlerësuar me 10 (dhjetë) pikë, duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi.

Lidhur me pretendimin e mësipër të ankimuesit, Komisioni gjykon se nuk qëndron pasi vlerësimi me pikë i ofertës së operatorit ekonomik “**CIVIL CONS**” SHPK është bërë në përputhje me kriterin e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmues “**A & E ENGINEERING**” SHPK nuk qëndron.

III.1.23.3. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik i ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit ka dorëzuar Shtojcën 10 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” ku Seksioni B: “**DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’**” të Pjesës III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” ka deklaruar se ka të puësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijm: “4 (katër) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacion/IT; 2 (dy) Inxhinier Elektrik; 2 (dy) Inxhinier Mekanik; 2 (dy) Inxhinier Mjedisi; 2 (dy) Inxhinier Gjeolog dhe 1 (një) inxhinier Gjeodezi dhe 1 (bnjë) inxhinier

gjeoinformatikë.”, si dhe ka dorëzuar kontratat e punës, diplomat dhe jetëshkrimet e këtyre punonjësve.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni gjykon se operatori ekonomik ofertues në fazën e ofertimit e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT** të dokumentave të tenderit.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK është vlerësuar me 10 (dhjetë) pikë, duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi.

Lidhur me pretendimin e mësipër të ankimuesit, Komisioni gjykon se nuk qëndron pasi vlerësimi me pikë i ofertës së operatorit ekonomik “**NET-GROUP**” SHPK është bërë në përputhje me kriterin e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmues “**A & E ENGINEERING**” SHPK nuk qëndron.

III.1.23.4. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik i ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “**ARENA MK**” SHPK për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT** të dokumentave të tenderit operatori ekonomik ofertues “**ARENA MK**” SHPK ka ofertuar si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “**ARENA MK SHPK & HTS COMPANY SHPK**” të krijuar me kontratën “Për bashkimin e përkohshëm të shoqërive tregtare” datë 30.01.2026, të lidhur midis shoqërisë “**ARENA MK**” SHPK dhe shoqërisë “**HTS COMPANY**” SHPK ku shoqëria “**ARENA MK**” SHPK ka marrë përsipër të realizojë 60% të shërbimit objekt prokurimi, ndërsa shoqëria “**HTS COMPANY**” SHPK ka marrë përsipër të realizojë 40% të shërbimit objekt prokurimi, ndërkohë që secili prej anëtarëve të këtij bashkimi ka dorëzuar Shtojcën 10 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” ku në Seksionin B: “**DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’**” të Pjesës III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” ku njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi shoqërisë dhe konkretisht operatori ekonomik “**ARENA MK**” SHPK ka deklaruar se ka të punësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijim: “**Në stafin kryesor ka të punësuar 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Gjeodet; 1 (një) Inxhinier Gjeolog; 2 (dy) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Mjeditë; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Elektroteknik dhe 1 (një) Inxhinier Markshajder, ndërsa në stafin mbështetës ka të punësuar 4 (katër) Inxhinier Ndërtimi; 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik; 1 (një) ekspert mjeditë; dhe 1 (një) Inxhinier Topograf.**”,

ndërsa operatori ekonomik **“HTS COMPANY”** SHPK ka deklaruar se ka të punësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijim: *“1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe 1 (një) Inxhinier Gjeodet.”*, si dhe ka deklaruar se disponon në stafin e tij 1 (një) Inxhinier Mjedisi, për të cilin është mbështetur në kapacitetet e shoqërisë **“HE & SK 11”** SHPK, duke paraqitur Akt Marrëveshjen datë 28.01.2026, të lidhur midis operatorit ekonomik **“HTS COMPANY”** SHPK dhe operatorit ekonomik **“HE & SK 11”** SHPK dhe Shtojcën 10 *“FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”* ku në Seksionin B: *“DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’”* të Pjesës III: *“Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”* ku operatori ekonomik **“HE & SK 11”** SHPK ka deklaruar se ka të punësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijim: *“1 (një) Inxhinier Mjedisi.”*, si dhe ka dorëzuar kontratat e punës, diplomat dhe jetëshkrimet e këtyre punonjësve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky bashkim operatorësh ekonomikë, Komisioni konstaton se njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi dhe konkretisht operatori ekonomik **“ARENA MK”** SHPK ka deklaruar se disponon në stafin e tij 1 (një) Inxhinier Mjedisi dhe konkretisht punonjës z. XX, ku referuar diplomës nr. 1475-B, datë 20.06.1991 të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XX i jepet titulli *“Kimist teknolog”*, duke mos dëshmuar se ka formimin profesional si inxhinier mjedisi, si dhe ka deklaruar se disponon në stafin mbashtetës një ekspert mjedisi dhe konkretisht z. XX, ku referuar diplomës nr. 4404, datë 17.07.1985 të lëshuar nga Fakulteti i Agronomisë pranë Universitetit të Tiranës, ku dëshmohet se z. XX i jepet titulli *“Agronom i lartë”*, duke mos dëshmuar se ka formimin profesional si inxhinier mjedisi.

Gjithashtu referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se operatorit ekonomik **“HTS COMPANY”** SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si subjekt mbi të cilin do të mbështetet operatorin ekonomik **“HE & SK 11”** SHPK shoqëruar me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe deklaratën e angazhimit të këtij të fundit, i cili angazhohet posaçërisht për të mbështetur operatorin ekonomik **“HTS COMPANY”** SHPK për kapacitetin teknik lidhur me disponimin e 1 (një) Inxhinieri Mjedisi. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: *“2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës”*. Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: *“4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”*. Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik **“HTS COMPANY”** SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, *“Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”* si subjekt mbështetës operatorin ekonomik **“HE & SK 11”** SHPK, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.3 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit, KPP gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: *“4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në*

kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”. Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik **“HTS COMPANY” SHPK** si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.3 **“Kapaciteti teknik”**, të Shtojcës 9 **“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT** të dokumentave të tenderit ndërkohë operatori ekonomik **“HTS COMPANY” SHPK** rezulton të jetë mbështetur plotësisht te subjekti mbështetës **“HE & SK 11” SHPK** i deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit çfarë bie ndesh edhe e parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 **“Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”**, të ligjit nr. 162/2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: **“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.”.** Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **“ARENA MK SHPK & HTS COMPANY SHPK”**, pasi anëtari i këtij bashkimi dhe konkretisht shoqëria **“ARENA MK” SHPK** nuk isponon në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedisi, ndërkohë që edhe anëtari tjetër i këtij bashkimi shoqërisht dhe konkretisht operatori ekonomik **“HTS COMPANY” SHPK** nuk e disponon në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedis, pasi ai është mbështetur plotësisht te operatori ekonomik **“HE & SK 11” SHPK** lidhur me kapacitetin teknik për disponimin në stafin e tij të 1 (një) inxhinierit mjedisi sikurse është përcaktuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 **“Kapaciteti teknik”**, të Shtojcës 9 **“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT** të dokumentave të tenderit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në

përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **“ARENA MK SHPK & HTS COMPANY SHPK”** në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për tu vlerësuar me pikë sipas kriterit të vlerësimit të përcaktuar në pikën në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, pasi nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit, pasi me dookumentacionin e dorëzuar nuk ka arritur të vërtetojë se disponon në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedisi.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit *“Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues **“ARENA MK”** SHPK është vlerësuar me 10 (dhjetë) pikë, duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi, ndërkohë që nuk plotëson kriterin kualifikues të sipërpërmendur.

Lidhur me pretendimin e mësipër të ankimuesit, Komisioni gjykon se qëndron pasi vlerësimi me pikë i ofertës së bashkimi i operatorëve ekonomikë **“ARENA MK SHPK & HTS COMPANY SHPK”** nuk është bërë në përputhje me kriterin e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, pasi vlerësimi me pikë duhej të bëhej vetëm pasi ky bashkim operatorësh ekonomik të dëshmonte se përmbush kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit lidhur me disponimin në stafin e tyre të 1 (një) inxhinieri mjedisi, ndaj dhe Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se oferta e këtij bashkimi operatorësh ekonomik duhet të skualifikikohet nga kjo procedurë prokurimi dhe duhet të vlerësohet me 0 (zero) pikë për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmues **“A & E ENGINEERING”** SHPK qëndron.

III.1.23.5. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik i ofertues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“ERALD-G”** SHPK për kriterin e vlerësimit *“Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të

përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit ka dorëzuar Shtojcën 10 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” ku Seksioni B: “**DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’**” të Pjesës III: “**Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit**” ka deklaruar se ka të përsuuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijm: “2 (dy) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; 1 (një) Inxhinier Mjedisi; 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe 1 (një) inxhinier Gjeodet”, si dhe ka dorëzuar kontratat e punës, diplomat dhe jetëshkrimet e këtyre punonjësve.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni gjykon se operatori ekonomik ofertues në fazën e ofertimit e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit “**Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar**”, të përcaktuar në pikën 4.4 “**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**” të Seksionit 4 “**Procedura**” të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues “**ERALD-G**” SHPK është vlerësuar me 10 (dhjetë) pikë, duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi.

Lidhur me pretendimin e mësipër të ankimuesit, Komisioni gjykon se nuk qëndron pasi vlerësimi me pikë i ofertës së operatorit ekonomik “**ERALD-G**” SHPK është bërë në përputhje me kriterin e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 “**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**” të Seksionit 4 “**Procedura**” të dokumenteve të tenderit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmues “**A & E ENGINEERING**” SHPK nuk qëndron.

III.1.23.6. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik i ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “**ZENIT&CO**” SHPK për kriterin e vlerësimit “**Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar**”, të përcaktuar në pikën 4.4 “**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**” të Seksionit 4 “**Procedura**” të dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit operatori ekonomik ofertues “**ZENIT&CO**” SHPK ka ofertuar si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “**ZENIT&CO SHPK & GRAMA SHPK**” të krijuar me kontratën “**Për bashkëpunim të përkohshëm**” datë 30.01.2026, të lidhur midis shoqërisë “**ZENIT&CO**” SHPK dhe shoqërisë “**GRAMA**” SHPK ku shoqëria “**ZENIT&CO**” SHPK ka marrë përsipër të realizojë 70% të shërbimit objekt prokurimi, ndërsa shoqëria “**GRAMA**” SHPK ka marrë përsipër të realizojë 30% të shërbimit objekt prokurimi, ndërkohë që secili prej anëtarëve të këtij bashkimi ka dorëzuar Shtojcën 10 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” ku në Seksionin B: “**DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’**” të Pjesës III: “**Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit**” ku njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi shoqërisë dhe konkretisht operatori ekonomik “**ZENIT&CO**” SHPK ka

deklaruar se ka të punësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijim: “1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektronik; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 1 (një) Inxhinier Mekanik; ; 1 (një) Inxhinier Mjedisi; 1 (një) Inxhinier Gjeodet dhe 1 (një) Inxhinier Gjeolog”, ndërsa operatori ekonomik “**GRAMA**” SHPK ka deklaruar se ka të punësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si në vijim: “1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Elektrik dhe 1 (një) Inxhinier Mekanik”, si dhe ka dorëzuar kontratat e punës, diplomat dhe jetëshkrimet e këtyre punonjësve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky bashkim operatorësh ekonomikë, Komisioni konstaton se njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi dhe konkretisht operatori ekonomik “**ZENIT&CO**” SHPK ka deklaruar se disponon në stafin e tij 1 (një) Inxhinier Mjedisi dhe konkretisht punonjësin z. XX, ku referuar diplomës nr. 3825, datë 14.05.1980 të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, ku dëshmohet se z. XX i jepet titulli “*Kimist teknolog*”, duke mos dëshmuar se ka formimin profesional si inxhinier mjedisi, ndërkohë që anëtari tjetër I këtij bashkimi operatorësh ekonomikë dhe konkretisht shoqëria “**GRAMA**” SHPK nuk ka deklaruar dhe nuk ka vërtetuar se disponon në stafin e tij I (një) inxhinier mjedisi.

Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 3 të nenit 88 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. 64 Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”. Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik “**ZENIT&CO**” SHPK dhe operatori ekonomik “**GRAMA**” SHPK kanë deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga secili prej tyre konkretisht në seksionin përkatës në pikën A, “*Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik*” se kanë ofertuar në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “**ZENIT&CO SHPK & GRAMA SHPK**” dhe ku referuar

parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar duhet që bashkimi i shoqërive duhet të plotësojë kriterin kualifikues të pikën 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, duke dëshmuar që të paktën njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi soperatorësh ekonomikë të disponojë në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedisi.

Komisioni gjykon se referuar dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “**ZENIT&CO SHPK & GRAMA SHPK**” nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*”, të Shtojcës 9

“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT të dokumentave të tenderit lidhur me disponimin në stafin e tyre të 1 (një) inxhinieri mjedisi, pasi pasi anëtari i këtij bashkimi dhe konkretisht shoqëria **“GRAMA” SHPK** nuk disponon në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedisi, ndërkohë që edhe anëtari tjetër i këtij bashkimi shoqërishë dhe konkretisht operatori ekonomik **“ZENIT&CO” SHPK** nuk e disponon në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedis, pasi z. **Kristaq Gjoka**, i deklaruar si i punësuar pranë kësaj shoqërie dhe që do të kryejë detyrën e inxhinierit të mjedisit, referuar diplomës nr. 3825, datë 14.05.1980 të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, dëshmohej se z. **XX** i jepet titulli *“Kimist teknolog”*, duke mos vërtetuar se ka formimin profesional të inxhinierit të mjedisit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **“ZENIT&CO SHPK & GRAMA SHPK”** në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për tu vlerësuar me pikë sipas kriterit të vlerësimit të përcaktuar në pikën në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, pasi nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit, pasi me dokumentacionin e dorëzuar nuk ka arritur të vërtetojë se disponon në stafin e tij 1 (një) inxhinier mjedisi.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit *“Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues **“ZENIT&CO” SHPK** është vlerësuar me 10 (dhjetë) pikë, duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi, ndërkohë që nuk plotëson kriterin kualifikues të sipërpërmendur.

Lidhur me pretendimin e mësipër të ankimuesit, Komisioni gjykon se qëndron pasi vlerësimi me pikë i ofertës së bashkimi i operatorëve ekonomikë **“ZENIT&CO SHPK & GRAMA SHPK”** nuk është bërë në përputhje me kriterin e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, pasi vlerësimi me pikë duhej të bëhej vetëm pasi ky bashkim operatorësh ekonomik të dëshmonte se përmbush kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit lidhur me disponimin në stafin e tyre të 1 (një) inxhinieri mjedisi, ndaj dhe Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se oferta e këtij bashkimi operatorësh ekonomik duhet të skualifikikohet nga kjo procedurë prokurimi dhe duhet të vlerësohet me 0 (zero) pikë për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmues **“A & E ENGINEERING” SHPK** qëndron.

III.1.24. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për vlerësimin me pikë të kriterit të vlerësimit të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të kriterit të vlerësimit *“Përvoja për punë të ngjashme”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“CIVIL CONS”** SHPK, , të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“NET-GROUP”** SHPK të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“ARENA MK”** SHPK të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“NET-GROUP”** SHPK dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“ZENIT&CO”** SHPK referuar dokumentacionit të ofertës të dorëzuar prej tyre në këtë procedurë prokurimi dhe të pasqyruar në pikën III.1.7., të këtij vendimi, si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

III.1.24.1. Lidhur me pretendimi e operatori ekonomik i ofertues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për vlerësimin me pikët maksimale për kriterin e vlerësimit *“Përvoja për punë të ngjashme”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“CIVIL CONS”** SHPK, për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“NET-GROUP”** SHPK dhe për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“ERALD-G”** SHPK, për kriterin e vlerësimit *“Kualifikimi e stafit kryesor të propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit operatori ekonomik **“A & E ENGINEERING”** SHPK, operatorit ekonomik ofertues **“CIVIL CONS”** SHPK, operatorit ekonomik ofertues **“NET-GROUP”** SHPK dhe operatorit ekonomik ofertues **“ERALD-G”** SHPK kanë dorëzuar përkthësisht dokumentacioni e cituar në pikën III.1.6 të këtij vendimi.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni mori në shqyrtim vetëm ato shërbime të ngjashme të cilat janë realizuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues **“A & E ENGINEERING”** SHPK gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit dhe që janë të ngjashme me objektin e prokurimit, nga ku rezultoi se vlera totale e këtyre shërbimeve të ngjashme është në vlerën **45.404.013,05** (*dyzet e pesë million e katëqind e katër mijë e trembëdhjetë presje zero pesë*) leke pa TVSH, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni mori në shqyrtim vetëm ato shërbime të ngjashme të cilat janë realizuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues **“CIVIL CONS”** SHPK gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit dhe që janë të ngjashme me objektin e prokurimit, nga ku rezultoi se vlera totale e këtyre shërbimeve të ngjashme është në vlerën **31.078.197,99** (*tridhjetë e një million e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje nëntëdhjetë e nëntë*) leke pa TVSH, duke e plotësuar

kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni mori në shqyrtim vetëm ato shërbime të ngjashme të cilat janë realizuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit dhe që janë të ngjashme me objektin e prokurimit, nga ku rezultoi se vlera totale e këtyre shërbimeve të ngjashme është në vlerën **55.587.226,12** (*pesëdhjet e pesë million e pesëqind e tetëdhjet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë presje dymbëdhjetë*) leke pa TVSH, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni mori në shqyrtim vetëm ato shërbime të ngjashme të cilat janë realizuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “**ERALD-G**” SHPK gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit dhe që janë të ngjashme me objektin e prokurimit, nga ku rezultoi se vlera totale e këtyre shërbimeve të ngjashme është në vlerën **12.520.000** (*dymbëdhjetë million e pesëqind e njëzet mijë*) leke pa TVSH, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit.

Nga shqyrtimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026 konstatohet se për kriterin e vlerësimit “*Përvoja për punë të ngjashme*”, të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK është vlerësuar me 7 (shtatë) pikë nga 10 (dhjetë) pikë maksimale të përcaktuara për këtë kriter vlerësimit, ndërkohë që operatori ekonomik ofertues “**CIVIL CONS**” SHPK është vlerësuar me 7 (shtatë) pikë nga 10 (dhjetë) pikë maksimale të përcaktuara për këtë kriter vlerësimit, ndërsa operatori ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK dhe operatori ekonomik ofertues “**ERALD-G**” SHPK janë vlerësuar përkatësisht me nga 10 (pikë), duke u vlerësuar me pikët maksimale të parashikuara nga autoriteti kontraktor për këtë kriter vlerësimi, duke argumentuar se operatori ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK dhe operatori ekonomik ofertues “**ERALD-G**” SHPK përfitojnë pikët maksimale, pasi: “*Ka punime civile dhe elektrike të ngjashme me ato të AK*”, ndërsa për vlerësimin me pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK ka argumentuar përcaktimin e pikëve, si në vijim: “*Ka punime civile . Ka punime të ngjashme me ato të AK, por nuk arrin vleren prej 10.000.000 leke pa TVSH, sipas DST, pasi kap vleren totale 3.787.048,6 leke pa TVSH. Ploteson 38% te ketij kriteri.*”, ndërsa për vlerësimin me pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “**CIVIL CONS**” SHPK ka argumentuar përcaktimin e pikëve, si në vijim: “*Ka punime civile . Ka punime të ngjashme me ato të AK, por nuk arrin vleren prej 10.000.000 leke pa TVSH, sipas DST, pasi kap vleren totale 1.105.542 leke pa TVSH. Ploteson 11% te ketij kriteri.*”.

Nga shqyrtimi i kriterit të vlerësimit “*Përvoja për punë të ngjashme*”, të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar dy metodologji për vlerësimin me pikë dhe

konkretisht metodologjinë “Vlera e shërbimeve të ngjashme” dhe metodologjinë “Natyra e shërbimeve të ngjashme”, ndërkohë që referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në vlerësimin me pikë të këtij kriteri vlerësimi ka përdorur metodologjinë “Natyra e shërbimeve të ngjashme”.

Lidhur me metodologjinë e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor Komisioni gjykon se nuk qëndron, pasi referuar kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, operatorët ekonomikë ofertues të sipërpërmendur e kanë plotësuar këtë kriter kualifikues, pasi komisioni i vlerësimit të ofertave i ka konsideruar të ngjashme me objektin e prokurimit shërbimet e ngjashme të realizuara prej tyre, ndërkohë që nga shqyrtimi i Shtojcës 7 “*FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*” të dokumenteve të tenderit shërbimi objekt prokurimi është si në vijim: “*Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Ndërtimi i Nënstacionit të ri 220/110 kV Traktora (ngjitur me nënstacionin ekzistues Traktora 110/20 kV), me një autotransformator 1x150 MVA”*”; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Linja Tirana 1 - Traktora”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Fuqizim i linjës 110 kV Kafaraj - Vlora 1 - Babicë dopio qark dhe shtrirje përcjellësi në një qark”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Linja e re dopjo qark Sharrë-Selitë dhe traktet përkatëse”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Ndërtimi i linjës së re Çorovodë - Këlcyrë tek qark si dhe traktet përkatëse”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Rikonstruksion i linjës Fier-Kafaraj dopio qark dhe trakt i ri linje 110 kV në N/St. Fier”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Ndërtimi i linjës 110 kV Zogu i Zi – Tirana Qendër dhe punime në N/Stacionin Tirana Qendër”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Mbrotjtja e bazamenteve të shtyllës Nr. 93 të linjës 110 kV Ulëz-Kurbnesh”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”*; *Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Kalimi në kabllor i segmentit të linjës 110 kV Traktora – Farkë në hyrje të N/St. Farkë” dhe Mbikëqyrje e punimeve për Kontratën me objekt: “Punime primare, furnizim dhe vendosje e një autotransformatori të ri trefazor 220/110 kV, 150 MVA, punime sekondare për përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese në nënstacionin Hoxhare”.*”, duke mos përcaktuar natyrën e këtij shërbimi vetëm për punime elektrike.

Gjithashtu Komisioni gjykon se metodologjia e përdorur nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave bie ndësh me kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*”, të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, kriter i cili i referohet vetëm shërbimeve të ngjashme dhe jo shërbimeve identike.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se vlerësimi me pikë të kriterit të vlerësimit “Përvoja për punë të ngjashme”, të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit, për ofertat e sipërpërmendura duhet të bëhet mbi bazën e vlerës totale të shërbimeve të ngjashme të realizuara nga këta operatorë ekonomikë ofertues dhe konkretisht operatori ekonomik ofertues “**NET-GROUP**” SHPK ka dëshmuar se gjatë tre viteve të fundit nga publikimi i procedurës së prokurimit ka realizuar shërbime të ngjashme me vlerën më të madhe dhe konkretisht në vlerën **55.587.226,12**

(pesëdhjet e pesë million e pesëqind e tetëdhjet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë presje dymbëdhjetë) leke pa TVSH, duke përfituar vlerësimin me 10 (dhjetë) pikë, ndërsa ofertuesit **“A & E ENGINEERING” SHPK**, **“CIVIL CONS” SHPK** dhe **“ERALD-G” SHPK** kanë dëshmuar se kanë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme përkatësisht në vlerat si në vijim: **“45.404.013,05 (dyzet e pesë million e katëqind e katër mijë e trembëdhjetë presje zero pesë) leke pa TVSH shoqëria “A & E ENGINEERING” SHPK, 31.078.197,99 (tridhjetë e një million e shtatëdhjet e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjet e shtatë presje nëntëdhjet e nëntë) leke pa TVSH shoqëria “CIVIL CONS” SHPK, dhe 12.520.000 (dymbëdhjetë million e pesëqind e njëzet mijë) leke pa TVSH shoqëria “ERALD-G” SHPK**”, duke u vlerësuar me pikë në raport me përqindjen që zënë vlerat e shërbimeve të ngjashme të realizuara nga secili prej tyre në raport me vlerën e shërbime të ngjashme të realizuara nga operatori ekonomik ofertues **“NET-GROUP” SHPK**.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes **“A & E ENGINEERING” SHPK** qëndron pjesërisht.

III.1.24.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik i ofertues **“A & E ENGINEERING” SHPK** për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“ARENA MK” SHPK** dhe të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“ZENIT&CO” SHPK** për kriterin e vlerësimit *“Përvoja për punë të ngjashme”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimin mësipërm në pikën III.1.23.4. dhe pikën III.1.23.6. rezulton se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik ofertues **“ARENA MK” SHPK** dhe e operatorit ekonomik ofertues **“ZENIT&CO” SHPK** do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit, objekt shqyrtimi, duke përmbushur qëllimin e operatorit ekonomik ankimes **“A & E ENGINEERING” SHPK**

III.1.25. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes **“A & E ENGINEERING” SHPK** përsa i përket vlerësimit me pikë të kriterit të vlerësimit të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të kriterit të vlerësimit *“Metodologjia e propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“CIVIL CONS” SHPK**, , të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“NET-GROUP” SHPK** të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“ARENA MK” SHPK** të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“NET-GROUP” SHPK** dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues **“ZENIT&CO” SHPK** referuar dokumentacionit të ofertës të dorëzuar prej tyre në këtë procedurë prokurimi dhe të pasqyruar në pikën III.1.7., të këtij vendimi, si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 13.03.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

III.1.25.1. Lidhur me pretendimi e operatori ekonomik i ofertues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për vlerësimin me pikët maksimale për kriterin e vlerësimit *“Metodologjia”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **NET-GROUP** SHPK, **“ERALD-G”** SHPK dhe **“CIVIL CONS”** SHPK, për kriterin e vlerësimit *“Metodologjia e propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.7 *“Kapaciteti teknik”*, të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TE PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit operatori ekonomik **“A & E ENGINEERING”** SHPK, operatorit ekonomik ofertues **“CIVIL CONS”** SHPK, operatorit ekonomik ofertues **“NET-GROUP”** SHPK dhe operatori ekonomik ofertues **“ERALD-G”** SHPK kanë dorëzuar përkthësisht dokumentacioni e cituar në pikën III.1.7 të këtij vendimi.

Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 21, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”* që të përzgjedhë në përputhje me nenin 87 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: cmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi (*mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese*) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 87 të ligjit për prokurimin publik, ku inter allia shprehet se oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret të tilla mund të përfshijnë cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij.

Gjithashtu, edhe në nenin 45 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, është përcaktuar se: *“Në kontratat, që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet, në:*

- a) *cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose*

- b) *organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose*
- c) *c) shërbimin, koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.”.*

Sa më sipër, në respekt të nenit 87 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 45 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë kriteret vlerësimi të përcaktimit të ofertës fituese, si edhe t’u japë peshë specifike me një sistem të posaçëm pikëzimi. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, faktin se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme ku vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes “**A & E ENGINEERING**” SHPK dhe së dyti në rrafshin krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë të vlerësuar me më shumë pikë konkretisht “**NET-GROUP**” SHPK dhe “**ERALD-G**” SHPK, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (*ratio legis*) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luan gjithashtu dhe metodologjia (Përfaqja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative), për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur ta peshojë me 30 pikë. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit rastin konkret termat e referencës. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në përcaktimin e pikëve për kriteret e sipërpërmendura fillimisht ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentat konkretë që pasqyrojnë elementët e sipërpërmendur për kriterin e metodologjisë dhe më pas në rrafshin krahasimor, duke përcaktuar se kush ka dhënë propozimet më të mira. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se referuar mënyrës së ndërtuar të kriterit dhe konkretisht atij të metodologjisë së propozuar synimi i autoritetit kontraktor lidhet me riprodhimin e termave të referencës së kryerjes së shërbimit, dhe jo të elementëve të tjerë favorizues, që në thelb do të

përbënin ofertën ekonomikë më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues “**A & E ENGINEERING**” SHPK, “**NET-GROUP**” SHPK dhe **ERALD-G**” SHPK, Komisioni konstaton se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur metodologjitë e tyre respektive sipas përcaktimeve në pikën III.1.7 të këtij vendimi, nga verifikimi në tërësi i metodologjive të propozuara nga secili prej këtyre operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton se në tërësi secili operator në metodologjinë e dorëzuar është mbështetur në termat e referencës të publikuar nga autoriteti kontraktor duke dhënë një përshkrim të shërbimit mbi bazën e termave të referencës.

Nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “**A & E ENGINEERING**” SHPK, rezulton se *prima facia* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e termave të referencës ndaj dhe vlerësimi me kaq pak pikë pra 10 i këtij operatori ekonomik është diskriminues, përse kohë që ka dhënë një pasqyrim të të gjithë elementëve të kërkuar nga AK sa i përket metodologjisë së propozuar. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik i detajuar, mbi arsyen e vlerësimit me 10 nga 30 pikë maksimale të metodologjisë për këtë operator ekonomik.

Nga ana tjetër, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e paraqitur nga operatori ekonomik “**NET-GROUP**” SHPK dhe **ERALD-G**” SHPK, edhe këta operator ekonomik ashtu sikurse operatori ekonomik ankimues kanë dhënë një përshkrim të shërbimit mbi bazën e termave të referencës. Konkretisht, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “**A & E ENGINEERING**” SHPK, rezulton se *prima facia* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, e cila përfshin përqasjen teknike dhe metodologjike, planin e punës, dhe aftësin organizative. Në përfundim, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “**A & E ENGINEERING**” SHPK, rezulton se *prima facia* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e termave të referencës.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë (në rastet kur nuk aplikohet përlllogaritje me formulë) megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me vlerësimin e pikëve për këtë kriter, nga shqyrtimi i proces-verbalit të argumentimit të vlerësimit të bërë nga anëtarët e

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si edhe analizuar në rrafshin krahasimor të metodologjise së propozuar nga këta tre operatorë ekonomikë, si edhe të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në raport me dy operatorët e tjerë **“NET-GROUP”** SHPK dhe **ERALD-G** SHPK, në respekt dhe të parimit të trajtimit të barabartë operatori ekonomik ankimues duhet vlerësuar me të njëjtat pikë sikurse është vlerësuar operatori ekonomik **“NET-GROUP”** SHPK dhe **ERALD-G** SHPK.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues **“A & E ENGINEERING”** SHPK qëndron pjesërisht.

III.1.25.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik i ofertues **“A & E ENGINEERING”** SHPK për rivlerësimin me më pak pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“ARENA MK”** SHPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik ofertues **“ZENIT&CO”** SHPK për kriterin e vlerësimit *“Metodologjia e propozuar”*, të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.1.23.4. dhe pikën III.1.23.6. rezulton se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik ofertues **“ARENA MK”** SHPK dhe e operatorit ekonomik ofertues **“ZENIT&CO”** SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit, objekt shqyrtimi, duke përmbushur qëllimin e operatorit ekonomik ankimues **“A & E ENGINEERING”** SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik **“A & E ENGINEERING”** SHPK në procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara*, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt *“Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025”* me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të

këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "A & E ENGINEERING" ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date: 2026/06/11 16:46:27 +02'00"
1da093cf4c36420eafb435b4d4e9f66920260611164625
61020

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.06.11
04:48:06